

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6027
E mërkurë, 3 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Grenelli nga Shtëpia e
Bardhë ushtron detyrën e
emisarit në dialogun
Kosovë - Serbi FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT, PA FITUESIN E ZGJEDHJEVE, PRITET TË VOTOHET QEVERIA E RE

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe partnerët e saj të koalicionit kanë shprehur bindjen se sot (e mërkurë) Kosova do të ketë qeverinë e re të udhëhequr nga Avdullah Hoti. Por, Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se askush nuk do të mund t'ia rrëmbejë fitoren kësaj partie. E njëjta ka bërë me dije se nuk qëndron prapa protestave të paralajmëruara. Në anën tjetër, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se askush nuk ka të drejtë të bëjë presion mbi deputetët, kurse njohësit e rrethanave politike në vend kanë deklaruar se edhe nëse arrin të votohet, qeveria Hoti do të jetë qeveri e brishtë dhe e varur nga Lista Serbe FAQE 4-5



OPINION

KRIZA EKONOMIKE,
MUNDËSI PËR NJË
MODEL TË RI EKONOMIK
KOSOVË - SHQIPËRI F. 10-11

Valon
MURATI



AKTUALE



VETËVENDOSJA FILLON
MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE
PËR PETICIONIN 'DUAM
ZGJEDHJE' F. 5

SHTYHET DERI MË 19 QERSHOR
AFATI I DEKLARIMIT TË
PASURISË PËR ZYRTARËT E
LARTË PUBLIKË F. 7

EKONOMI

MË 9 QERSHOR MBAHET
ANKANDI I SHTATË I LETRAVE
ME VLERË F. 9

BANKA BOTORE: 88 PËR QIND
E SEKTORIT PRIVAT NË
KOSOVË ËSHTË GODITUR
GJATË KOHËS SË PANDEMISË F. 9

SPORT

ISLAMI: BALLKANI
KUNDËRSHTAR I VËSHTIRË,
POR FERONIKELI SYNON
FINALEN F. 16

NË MINIERËN E ARTANËS HUMBËN JETËN NJË INXHINIER DHE NJË XEHETAR. FAQE 3



Në minierën e Artanës paraditen e së martës kanë humbur jetën aksidentalisht një inxhinier dhe një xehetar. Bëhet fjalë për Idriz Gërbeshin dhe Haki Arifajn. Gërbeshi ka qenë xehetar me banim në Hajvali, ndërsa Haki Arifaj inxhinier i diplomuar i xehetarisë nga fshati Gillogovc, Komuna e Lipjanit. Pas marrjes së lajmit tragjik, në vendin e ngjarjes ka dalë kryemi-

nistri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja në detyrë e Ekonomisë, Rozeta Hajdari dhe ushtruesi i detyrës së ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Pas kësaj ngjarje qeveria ka ndarë 30 mijë euro për familjen Gërbeshi dhe Arifaj. Lidhur me këtë ngjarje kanë reaguar krerët institucionalë dhe partiakë, të cilët kanë kërkuar që të zbardhen rrethanat e vdekjes së tyre

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Grenelli nga Shtëpia e Bardhë ushtron detyrën e emisarit në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Këshilltari i presidentit Donald Trump për Siguri Kombëtare, Robert O'Brien, ka folur pasi Richard Grenell ka dhënë dorëheqje nga pozita e ambasadorit të ShBA-së në Gjermani. O'Brieni ka treguar se Richard Grenelli ka vullnet për t'u shërbyer Shteteve të Bashkuara të Amerikës në pozitën e emisarit për dialogun Kosovë-Serbi. Ai ka thënë se Grenelli do të punojë jashtë Shtëpisë së Bardhë dhe me orar të përgjysmuar. "I jam

mirënjohës Ricut për vullnetin e treguar për t'i shërbyer kombit tonë në kapacitete të pjesshme si përfaqësues special për negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke ushtruar detyrën e tij nga Shtëpia e Bardhë", është thënë në qëndrimin e O'Brien të publikuar nga National Security Council.

Ndërkohë gazetarja e Bloombergut, Jennifer Jacobs, ka thënë se Richard Grenelli do të punojë në kampusin e

Shtëpisë së Bardhë në ndërtesën e "Eisenhower Executive Office Building". "Më është thënë se aleati i Trumpit, Richard Grenell, ka dhënë dorëheqje nga roli i tij si ambasador në Gjermani të hënën. Ai është i fokusuar në rolin e tij si përfaqësues special për negociatat Kosovë - Serbi. Ai të hënën është zhvendosur në një zyrë në kompleksin e Shtëpisë së Bardhë në EEOB", ka shkruar Jacobs në llogarinë e saj në "Twitter".



Rifillimi i dialogut Kosovë - Serbi, Lajçaku njofton se e ka përkrahjen e 27 shteteve të BE-së



PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Në një panel të Komitetit për Politikë dhe Siguri të Bashkimit Evropian (BE) është diskutuar edhe për rifillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pjesëmarrës ka qenë edhe përfaqësuesi special i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, i cili në llogarinë e vet në

"Twitter" ka njoftuar se ka marrë përkrahjen e 27 anëtarëve të BE-së për ta drejtuar dialogun. "Mirënjohës për mbështetjen e fortë që mora nga 27 shtetet anëtare të BE-së sot. Diskutim shumë inkurajues për mandatin tim dhe rrugën përpara", ka shkruar Lajçaku, duke shpërndarë një postim të ambasadores aus-

triale në BE, Christina Kokkinakis. "Në ndërkohë në Bruksel. Një diskutim i shkëlqyeshëm me përfaqësuesin special të BE-së, Miroslav Lajçak, për rinisjen e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në BE", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Twitter".

Rama: PS-ja ka mbaruar punën për reformën zgjedhore



TIRANË, 2 MARS - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se preferon të heshtë, të paktën edhe për disa orë, ose ndoshta një ditë, mbi negociatat që kanë vijuar të martën me dyer të mbyllura dhe me hyrje-daljet e ambasadorëve për arritjen e një marrëveshjeje për reformën zgjedhore. Ai ka thënë se Partia Socialiste (PS) të cilën e drejton e ka kryer punën e saj. "Ne kemi mbaruar punën tonë. Besojmë se produkti është aty. Nuk ka ardhur radha për të komentuar unë përderisa të

tjerë janë përfshirë në këtë proces. Do të më falni një shtyrje 24 orë për të folur. Sa i takon takimit në Shqipërinë e vitit 2020, nuk është e hijshme për ne që për çështje të brendshme që lidhen me vendosjen e rregullave të lojës si reforma zgjedhore, ku palët janë dy skuadra a më shumë që do të zhvillojnë një finale, ulen e bien dakord, të bëhet me ambasadorë që hyjnë e dalin nëpër dyer selishë. Megjithatë, është për të thënë faleminderit se, përderisa ka palë që nuk e

bëjnë hapin vetë, duhet ndihmë", ka thënë Rama në një konferencë për medie në strukturën e re spitalore për përballimin e situatës së Covid-19. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se është i gatshëm të takohet edhe me liderin e PD-së, Lulzim Basha. "Disa herë i kam kërkuar kryeministrit të kohës të uleshim për gjërat që duheshin diskutuar. Tani kanë ndërruar pozicionet. Kur ishim në opozitë unë kërkoja të uleshim, tani si kryeministër kërkoj të ulen", është shprehur Rama.

Basha: Opozita e angazhuar për përmbylljen e reformës zgjedhore

TIRANË, 2 QERSHOR - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian (BE), Oliver Varhelyi, ka kërkuar miratimin e reformës zgjedhore në Shqipëri dhe atë në mënyrë konsensuale dhe jo të njëanshme. Me këtë rast, lideri i PD-së, Lulzim Basha, ka falënderuar komisionarin e BE-së, duke thënë se opozita është e përkushtuar që të

përmbillet ky proces. "Faleminderit komisionarit Oliver Varhelyi për përkushtimin për konsensus të të gjitha forcave politike për reformën elektorale në Shqipëri! Opozita është plotësisht e angazhuar dhe po kontribuon për ta përmbyllur reformën me garanci të mjaftueshme për një proces të ndershëm zgjedhor. Kjo është e

rëndësishme për ta rikthyer besimin e shqiptarëve te demokracia pas manipulimeve të rënda zgjedhore dhe skandaleve të blerjes së votave në zgjedhjet e shkuara dhe po kaq përcaktuese për përmbushjen e një prej kriterëve të rëndësishme nga 15 kushtet për integrimin evropian të Shqipërisë", ka thënë Basha.



Në minierën e Artanës humbën jetën një inxhinier dhe një xehetar

Në minierën e Artanës paraditen e së martës kanë humbur jetën aksidentalisht një inxhinier dhe një xehetar. Bëhet fjalë për Idriz Gërbeshin dhe Haki Arifajn. Gërbeshi ka qenë xehetar me banim në Hajvali, ndërsa Haki Arifaj inxhinier i diplomuar i xehetarisë nga fshati Glllogovc, komuna e Lipjanit. Pas marrjes së lajmit tragjik në vendin e ngjarjes ka dalë kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja në detyrë e Ekonomisë, Rozeta Hajdari dhe ushtruesi i detyrës së ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Pas kësaj ngjarjeje qeveria ka ndarë 30 mijë euro për familjen Gërbeshi dhe Arifaj. Lidhur me këtë kanë reaguar krerët institucionalë dhe partiakë, të cilët kanë kërkuar që të zbardhen rrethanat e vdekjes së tyre



KPMM-ja thotë se të gjitha instancat po merren me rrethanat e vdekjes së dy punëtorëve në Artanë

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka theksuar se pas marrjes së informacionit për këtë ngjarje tragjike, të gjitha njësitet relevante kanë shkuar në vendin e ngjarjes. "Punëtorët që humbën jetën janë një xehetar dhe një inxhinier të moshës 50 dhe 51-vjeç. Ngjarja ka ndodhur me rastin e shembjes së pjesës tavanore të punishtes në të cilën ndodheshin gjatë kohës kur ishin duke kryer punën e tyre punëtorët e këtij nderimi, ndërsa 3 punëtorët nga punishtet e tjera i kanë shpëtuar shembjes dhe kanë pësuar lëndime të lehta trupore. KPMM-ja, pas marrjes së informatës, ka reaguar menjëherë dhe në vendin e ngjarjes gjendet kryesuesi i bordit të KPMM-së dhe tre anëtarët e këtij nderimi, si dhe kryespektori i KPMM-së. Gjithashtu, në vendin e ngjarjes është edhe njësia e shpëtimit dhe e ndihmës së parë, ku u është ofruar ndihma e parë punëtorëve që janë të shpëtuar, të cilët kanë pasur lëndime të lehta", ka njoftuar KPMM-ja.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Paraditen e së martës një xehetar dhe një inxhinier, të moshës 50 dhe 51-vjeçar, kanë humbur jetën në minierën e Artanës pasi është shembur një pjesë e punishtes në të cilën ndodheshin duke punuar. Fatmir Gërguri, kryeinspektor i minierave, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se të martën ka ndodhur një aksident në minierën e Artanës si pasojë e shembjes së galerisë së kësaj miniere. "Po, fatkeqësisht, kemi dy viktima si pasojë e shembjes së galerisë", ka thënë ai. Pas ngjarjes tragjike në Artanë, menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes përfaqësuesit e institucioneve, si dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja në detyrë e Ekonomisë, Rozeta Hajdari dhe ushtruesi i detyrës së ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Po në vendin e ngjarjes kanë shkuar edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Lidhur me këtë aksident kanë reaguar edhe krerët institucionalë të vendit.

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), e cila drejtohet nga Rozeta Hajdari, ka shprehur ngushëllime për familjarët e viktimave. Sipas kësaj ministrie, autoritetet e Republikës së Kosovës janë duke u angazhuar maksimalisht për t'u dalë në ndihmë të gjithë minatorëve dhe familjarëve të prekur. "Shprehim keqardhje të thellë për fatkeqësinë e ndodhur sot, më 2 qershor, në minierën e Artanës, ku kanë humbur jetën Idriz Gërbeshi dhe Haki Arifaj.

Idriz Gërbeshi ka qenë xehetar me banim në Hajvali, ndërsa Haki Arifaj inxhinier i diplomuar i xehetarisë nga fshati Glllogovc, Komuna Lipjan. Ngjarja ka ndodhur me shembjen e papritur të masës shkëmbore në minierën e Artanës. Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike u shpreh ngushëllime të gjithë familjarëve dhe shoqërisë së të ndjerëve. Autoritetet e Republikës së Kosovës po angazhohen maksimalisht për t'u dalë në ndihmë të gjithë minatorëve dhe familjarëve të prekur", është thënë në reagimin e MEPTINIS-it. Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se është thellësisht i pikëlluar me humbjen e jetës së dy punonjësve në minierën e Artanës si pasojë e shembjes së dheut. Thaçi u ka shprehur ngushëllime familjeve, të afërmeve dhe gjithë kolegëve të tyre. "Thellësisht i pikëlluar me humbjen e jetës së dy punonjësve në Minierën e Artanës si pasojë e shembjes së dheut. U shpreh ngushëllime të thella familjeve, të afërmeve dhe gjithë kolegëve të tyre!

Institucionet e Kosovës duhet të përkujdesen që punëtorët të jenë gjithmonë të mbrojtur në vendet e tyre të punës!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse i nominuari për kryeministër, Avdullah Hoti, ka thënë se të gjithë janë tronditur nga lajmi i kobshëm i shuarjes së jetës së dy bashkëqytetarëve, Idriz Gërbeshi dhe Haki Arifaj, si pasojë e shembjes së dheut në minierën e Artanës. "Sot, një inxhinier dhe një xehetar yni, në vendin e punës u shndërruan në shembull flijimi për të mirën e vendit. Në këto çaste dhembjeje e trishtimi, shpirtërisht dhe në lutje jemi me familjet e të ndjerëve! Zoti i bekoftë Idriz Gërbeshin dhe Haki Arifajn! Zoti i bekoftë familjet e tyre!", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka ngushëlluar familjet e dy minatorëve të vdekur nga shembja e dheut në Minierën e Artanës. "Vdekja e 2 minatorëve nga shembja e dheut në minierën e Artanës është lajm i hidhur jo vetëm për familjet e tyre, por edhe për gjithë Kosovën. U shprehim

ngushëllime të sinqerta familjeve të viktimave në emër të Kuvendit të Kosovës. Fati tragjik i dy luanëve të nëntokës, të cilët janë sinonim i sakrificës për vendin, duhet të jetë alarm për institucionet të cilat duhet të bëjnë më shumë për krijimin e kushteve të punës dhe sigurisë në sektorin minerar dhe atë të ndërtimit. E ndajmë dhembjen me ju në këto çaste të rënda!", është thënë në telegram ngushëllimin e kryetares Osmani.

Ndaj këtij rasti tragjik ka reaguar edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. Humbjen e dy minatorëve Veseli e ka quajtur ngjarje të rëndë. Ai u ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjeve që humbën më të dashurit e tyre. "Në këto momente të vështira jemi afër të gjithë minatorëve të prekur dhe të afërmeve të tyre të cilët kanë përjetuar këtë dhimbje. Të hetohen dhe sqarohen sa më parë rrethanat e kësaj tragjedie", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se është i tronditur nga lajmi për humbjen e jetës së dy minatorëve në Artanë për shkak të shembjes së dheut në minierë. "U bëj thirrje institucioneve të vendit që të marrin masa në sigurinë e minatorëve dhe mbrojtjen në punë. Ngushëllime familjes së minatorit dhe të inxhinierit që humbën jetën tragjikisht, ndërsa të lënduarve u uroj shërim të shpejtë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Po ashtu, lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka bërë një reagim në llogarinë e vet në "Facebook" pas kësaj ngjarje tragjike, duke u shprehur ngushëllime familjarëve të viktimave. "Jam prekur thellë nga raportimi se sot dy minatorë kanë humbur jetën

Qeveria ndihmon familjet e minatorëve me nga 30 mijë euro

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se do t'u qëndrojë afër familjeve të dy minatorëve që kanë ndërruar jetë tragjikisht në minierën e Artanës. Sipas njoftimit të qeverisë, familjes Gërbeshi dhe Arifi u janë ndarë nga 30 mijë euro. "Dy minatorë, inxhinieri Haki Arifaj e xehetari Idriz Gërbeshi, vdiqën sot nga shembja e

dheut në horizontin e katërt, punishtja 24/9, në minierën e Artanës. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka vendosur t'i ndihmojë familjet e tyre me nga 30 000 euro dhe bursë për fëmijët që po e ndjekin shkollimin. Djalit të madh të Idrizit, 21 vjeç, do t'i ofrohet mundësi punësimi në minierë", ka njoftuar qeveria.

në punë në minierën e Artanës. Ngushëllimet e mia më të sinqerta për familjet e viktimave dhe minatorët e Kosovës. Kjo është një ditë e trishtë për Kosovën. Shumë nga familja ime kanë punuar në atë minierë dhe dhimbja ime është jashtëzakonisht e madhe. Mendimet e mia janë me familjet dhe minatorët e Kosovës në këto çaste të vështira për ta", ka shkruar Pacolli.

Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se është i tronditur me lajmin për vdekjen tragjike të dy minatorëve në minierën e Artanës. Ai ka thënë se në këto çaste të rënda për familjet dhe minatorët, bashkëndjen me dhimbjen e tyre. "Në emrin tim dhe të Nismës Socialdemokrate u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjeve të minatorëve që sot tragjikisht humbën jetën. Uroj që sa më parë të shërohen të gjithë të lënduarit nga shembja e dheut në minierë", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Për këtë ngjarje ka reaguar edhe Partia Socialdemokrate.

KRYESIA E KUVENDIT TË KOSOVËS KA CAKTUAR PËR SOT (MËRKURË) NË ORËN 11:00 MBAJTJEN E SEANCËS

SOT, PA FITUESIN E ZGJEDHJEVE,

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe partnerët e saj të koalicionit janë shprehur të bindur se sot (e mërkurë) Kosova do ta ketë qeverinë e re të udhëhequr nga Avdullah Hoti. Ndërsa Lëvizja Vetëvendosja ka bërë me dije se askush nuk do të mund t'ia rrëmbejë fitoren e zgjedhjeve kësaj partie, kurse ka bërë me dije se nuk qëndron prapa protestave të paralajmëruara. Në anën tjetër, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar që askush nuk ka të drejtë të bëjë presion mbi deputetët, kurse njohësit e rrethanave politike në vend kanë deklaruar se edhe nëse arrin të votohet, qeveria Hoti do të jetë qeveri e brishtë dhe e varur nga Lista Serbe

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që sot (mërkurë) në orën 11.00 të mbahet seanca parlamentare në të cilën pritet të votohet qeveria e re e drejtuar nga Avdullah Hoti i LDK-së.

Zyrtarët e LDK-së kanë bërë me dije se i kanë votat e mjaftueshme për ta votuar qeverinë e re. Pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, është shprehur i bindur se Kosova nga e mërkura do të ketë qeveri të re. Duke komentuar paralajmërimet e disa deputetëve të LDK-së, se nuk do të votojnë pro qeverisë Hoti, Gashi ka thënë që secili deputet e ka të drejtën të votojë sipas vlerësimit personal. "Mendoj se është e padinjitetshme që deputetët të konsiderohen si vota. Gjithsecili deputet është personalitet në vete dhe duhet

të respektohet si i tillë. Nesër gjithsecili deputet e ka mundësinë që ta japë vlerësimin e vet përmes diskutimit në Kuvend dhe në fund edhe përmes votës. Trajtimi i deputetit si votë është e padinjitetshme", ka thënë Gashi.

Ai nuk e ka komentuar votën e mundshme kundër të Haxhi Shalës nga Nisma Socialdemokrate. "Pyeteni Fatmir Limajn për këtë çështje, sepse nuk është çështje e imja. Është çështje e brendshme e Nismës dhe nuk kam koment për këtë", është shprehur ai. Shefi i deputetëve të LDK-së nuk ka mundur të tregojë nëse këtë seancë do ta udhëheqë kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila është shprehur kundër kësaj qeverie. "Nuk e di, është çështje procedurale. Vjosa Osmani është kryetare e Kuvendit dhe vendos me autonominë e saj nëse do të udhëheqë një seancë ose jo", ka deklaruar Gashi.

Edhe partnerja tjetër e

koalicionit, AAK-ja, ka shprehur optimizëm se të mërkurën do të votohet qeveria e re. Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se qeveria e re do ta përshpejtojë shpëtimin ekonomik të vendit. "Pandemia ka shkaktuar pasoja shumë të mëdha për ekonominë e vendit. Shumë më shumë sesa statistikën po thonë. Shpëtimi i ekonomisë tonë sot është beteja e parë urgjente. Një qeveri e votuar nesër e përshpejton shpëtimin ekonomik të vendit. Një qeveri që nuk e ka mandatin nga parlamenti, që nuk mund të hartojë ligje dhe të marrë vendime, vetëm sa e vazhdon agoninë e gjithanshme në vend dhe dobësimin ekonomik të vendit", ka deklaruar Haradinaj gjatë takimit me strukturat e AAK-së në Gjakovë.

Për këto arsyeje, ka thënë ai, AAK-ja ka vendosur të bëhet pjesë e qeverisë së re. "Për këtë arsye Aleanca nuk ka hezitu

t'i japë përkrahje votimit të një qeverie të re në vend dhe e pret me gëzim nesër votimin, që të fillojë koha dhe ora e shpëtimit ekonomik të vendit. Edhe një herë ju siguroj se urgjenca jonë kryesore është shpëtimi ekonomik", ka thënë Haradinaj. Ndërsa, ëvizja Vetëvendosje nuk ka treguar nëse do të marrë pjesë apo jo në këtë seancë. Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, ka deklaruar për media se kjo parti nuk do të lejojë që partitë e tjera t'ia rrëmbejnë fitoren. "Ata kanë një target, që ta rrëmbejnë fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje, fitoren e qytetarëve dhe ta tjetërsojnë atë", ka deklaruar Selimi. Sipas tij, qëndrimi i kësaj parti të mërkurën do të jetë në anën e të drejtës së qytetarëve.

"Lëvizja Vetëvendosje, si gjithmonë, edhe nesër do të jetë në anën e të drejtës së qytetarëve për të zgjedhurin e vet. Do të jetë në përputhje me qëndrimet e saj politike dhe secili deputet do të jetë në përputhje me mandatin

e tij dhe me besimin që i kanë dhënë qytetarët", ka deklaruar Selimi.

Qeveria e re do të jetë e brishtë

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se qeveria e re, nëse arrin të votohet në Kuvend, do të jetë qeveri e brishtë. Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për "Epokën e re" se nuk do të ndalen përpjekjet e shumicës parlamentare derisa të votohet qeveria e re. "Në qoftë se gjithë kjo krizë politike është shkaktuar për të krijuar një qeveri të re, atëherë do të bëhet çmos që ajo të votohet. Mund të ndodhë që mos të votohet të mërkurën, por përpjekjet nuk do të ndalen për t'i siguruar numrat e nevojshëm", ka thënë Mushkolaj.

Ai ka vlerësuar se kjo qeveri do të jetë e varur nga deputetët e Listës Serbe. "LV-ja mund ta shprehë pakënaqësinë për situatën e krijuar, por

NCËS PËR VOTIMIN E QEVERISË SË RE

PRITET TË VOTOHET QEVERIA E RE



interpretim të Kushtetutës të mos kundërshtohet sikur që gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese duhet të kursehen nga kërcënimet, shantazhimet dhe linçimet publike e që, përjashtuar disa raste me të cilat po merret policia, gjendja nuk ka përshkallëzuar siç ishte paralajmëruar”, ka vlerësuar KMDLNj.

Sipas këshillit, askush nuk guxon të ushtrojë presion ndaj deputetëve në këtë seancë. "KMDLNj shpreson dhe pret që edhe votimi për Qeverinë e re të Kosovës të bëhet në suaza të një demokracie parlamentare duke respektuar

çdo votë si shprehje e lirë e vullnetit të deputetit, pavarësisht nëse është për apo kundër. Askush nuk ka të drejtë të ushtrojë presion në deputetë për përcaktimin e votës së tyre. Seanca për votim të qeverisë së re me asnjë mënyrë nuk guxon të përshkallëzojë në veprime joparlamentare, ndryshe ata që do ta bëjnë këtë do të marrin përgjegjësi politike dhe do të kenë pasoja në zgjedhjet e ardhshme që, sipas KMDLNj-së, nuk do të jenë larg. Votoni sipas bindjes suaj dhe respektoni edhe votën që është e kundërt me tuajën”, ka

vlerësuar ky këshill/ Pas rrëzimit të qeverisë së drejtuar nga Albin Kurti, LDK-ja ka arritur koalicion të bashkëqeverisjes me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Nismën Socialdemokrate dhe minoritetet. Ndërsa AKR-ja ka deklaruar se do ta votojë qeverinë e re, por ende nuk ka vendosur nëse do të jetë pjesë e saj.

Më 30 prill, ditën që presidenti Hashim Thaçi ka mandatuar Avdullah Hotin për formimin e qeverisë së re, Lëvizja Vetëvendosje i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar interpretimin e

kushtetutshmërisë së dekretit të presidentit. LV-ja pretendonte se presidenti Thaçi kishte bërë shkelje kushtetuese kur kishte nxjerrë dekretin për mandatin e Hotit për shkak se kjo e fundit nuk e kishte konsumuar të drejtën e saj për propozimin e mandatarit të ri pas rrëzimit të qeverisë. Por, Gjykata Kushtetuese e shpalli të ligjshëm dekretin e Thaçit. Nëse qeveria Hoti do t'i marr votat e nevojshme në Kuvend, atëherë Kosova për herë të parë do të ketë një qeveri në kuadër të së cilës nuk është partia fituese e zgjedhjeve.

Vetëvendosja fillon mbledhjen e nënshkrimeve për petitionin 'Duam zgjedhje'

Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka nisur mbledhjen e nënshkrimeve edhe në formë fizike për petitionin "Duam zgjedhje". Zyrtarët e LV-së kanë deklaruar se çdo nënshkrim në petitionin për zgjedhje të reja është votë kundër çfarëdo qeverie që krijohet nga marrëveshjet e fshehta. Ata kanë treguar se deri më tani përmes petitionit onlin kanë mbledhur mbi 45 mijë nënshkrime

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Lëvizja Vetëvendosje ka nisur mbledhjen e nënshkrimeve për petitionin "Duam zgjedhje" edhe në formën fizike. Zyrtarët e këtij subjekti politik kanë deklaruar të martën se synojnë që përmes pikave në të gjitha qytetet e Kosovës t'ua mundësojnë qytetarëve nënshkrimin e këtij peticioni me kërkesën për zgjedhje të reja. Zëdhënësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Arlind Manxhuka, në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka njoftuar se deri tani nga peticioni online janë mbledhur mbi 45 mijë nënshkrime. "Prej sot jemi vendosur në çdo qytet të Kosovës në mbledhje të nënshkrimeve për petitionin që kërkesë të vetme ka zgjedhjet e reja. Nga peticioni online tashmë janë bërë mbi 45 mijë nënshkrime, ndërkohë që ka një fluks të madh të qytetarëve që po nënshkruajnë fizikisht", ka shkruar ai.

Manxhuka është deklaruar edhe për protestat e paralajmëruar për nesër duke thënë se LV-ja nuk qëndron prapa tyre. "Në anën tjetër ne kemi parë shumë organizime e 'event'-e nëpër rrjetet sociale për protestë dhe jemi duke marrë shumë pyetje nga qytetarë të shumtë, por ashtu siç jemi deklaruar edhe ditë më parë, ne nuk qëndrojmë prapa këtyre organizimeve. Po ashtu, ne i sigurojmë qytetarët dhe anëtarët se me kohë do të njoftohen për çdo organizim të Lëvizjes Vetëvendosje. Nuk mund të ketë qeveri përkundër vullnetit të popullit e pa zgjedhje, pa legjitimitet e përkundër Kushtetutës. Zgjedhjet janë e vetmja rrugë për të dalë nga kjo krizë", ka shkruar Manxhuka.

Gjatë ditës së martë peticionin e kanë nënshkruar disa figura të njohura të LV-së. Ndër të parët që e kanë nënshkruar këtë peticion ka qenë edhe babai i Astrit Deharit, Avniu. "Axa Avni Dehari sapo nënshkroi peticionin me kërkesë shpalljen e zgjedhjeve



në sheshin 'Nëna Terezë'. Jemi këtu deri në orën 18:00. Ju mirëpresim", ka shkruar aktivisti i LV-së, Valdrin Ahmeti.

Peticionin e kanë nënshkruar edhe deputetja e LV-së, Fitore Pacolli. Pas nënshkrimit ajo ka vlerësuar se qytetarët po deklarohen hapur kundër kthimit të partive të tjera në pushtet. Në llogarinë e vet në "Facebook", ajo ka shkruar se çdo nënshkrim në petitionin për zgjedhje të reja është votë kundër çfarëdo qeverie që krijohet nga marrëveshjet e fshehta e për interesa personale. "Qytetarët nuk lejojnë të shkelet mbi vullnetin e tyre. Ata sot kanë dalë në sheshet e çdo qyteti të Kosovës dhe po

deklarohen hapur dhe qartë kundër kthimit të partive kriminale në pushtet. Sot çdo nënshkrim në petitionin për zgjedhje është votë kundër çfarëdo qeverie që krijohet nga marrëveshjet e fshehta e për interesa personale e klienteliste. Kosova nuk është as e Hashimit e as Isës. Kosova është e qytetarëve dhe vetëm ata mund të vendosin për të ardhmen e saj. Nënshkruaje peticionin #duamzgjedhje!", ka shkruar Pacolli.

Mbledhja e nënshkrimeve për petitionin ka filluar pasi Gjykata Kushtetuese i ka dhënë të drejtë dekretit të presidentit Hashim Thaçi për formimin e qeverisë edhe pas mocionit.

mbështetësit e qeverisë së re do ta gjejnë mënyrën për ta votuar atë. Përndryshe, qeveria e re do të jetë mjaft e brishtë, me ndikim të madh të deputetëve të Listës Serbe dhe është pak e besueshme se do të marrë vendime për të cilat edhe po krijohet", ka thënë Mushkolaj. Kurse Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë thirrje që të respektohet aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për formimin e qeverisë së re. Përmes një deklarate për medie ky këshill ka vlerësuar se edhe gjykatësit e Kushtetueses duhet të kursehen nga kërcënimet, shantazhimet dhe linçimet. "Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për dekretin e presidentit Thaçi pati kundërshtime dhe pakënaqësi verbale, por që nuk ndikuan në gjendjen e sigurisë. KMDLNj me një thirrje publike ka kërkuar që vendimi i Gjykatës si një akt i pakthyeshëm dhe vendim i autoritetit suprem për

Punëtorja e një çerdheje në Fushë-Kosovë dyshohet për koronavirus



FUSHË-KOSOVË, 2 QERSHOR (ER) - Një punëtorë e një çerdheje në Komunën e Fushë-Kosovës është duke u dyshuar se ka pasur kontakt me një person të infektuar me koronavirus dhe për këtë arsye komuna ka vendosur që ky institucion të mos hapet edhe për një kohë. Komuna e Fushës-Kosovës ka

njoftuar se kur të sqarohet rasti do të merret edhe vendimi për hapje. "Institucioni Edukativ Arsimor-Parashkollor 'Gëzimi Ynë' nuk do të hapet edhe për një kohë edhe pse është i gatshëm të ofrojë shërbim. Arsyja e moshapjes është një rast i dyshimtë kontakti i një

punëtorë në këtë institucion me familjarët e të infektuarve nga Komuna e Vushtrrisë. Në momentin kur të krijohen rrethanat dhe të sqarohet ky rast, atëherë do të merret edhe vendimi për hapjen e IEAP 'Gëzimi Ynë' Faleminderit për mirëkuptim!", ka njoftuar Komuna e Fushë-Kosovës.

Hysni dhe Nakije Gashi vazhdojnë ta ndajnë pensionin e tyre për fëmijët jetimë të Malishevës

MALISHEVË, 2 QERSHOR (ER) - Hysni dhe Nakije Gashi vazhdojnë ta ndajnë pensionin për fëmijët jetimë malishevas, në veçanti për familjet që kanë nevojë sociale. Ata deri më tani ka ndarë rreth 2 000 euro për familjet skamnore në Malishevë. "Deri më tash ai për këto familje ka ndarë një mijë e njëqind e pesëdhjetë euro (1 950 euro), kurse shpërndarjen

e ka bërë personi përgjegjës në institucionet komunale", ka njoftuar Komuna e Malishevës. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar ata në emër të komunës dhe familjeve që kanë pranuar ndihmën dhe që do ta marrin edhe kësaj here. "Ju dje ishit ndër profesorët e parë që hapët dritaren e arsimit shqip në

Komunën e Malishevës. Sot po hapni dritaren e humanizmit, duke ndarë pensionin tuaj për familjet malishevase në nevojë, veçmas për jetimët edhe në këtë moshë të shtyrë, prandaj si ish-nxënës i juaji dhe kryetar komune, ju jam mirënjohës për veprën e madhe humane që po bëni për qytetarët e Malishevës", ka thënë Begaj.



Nënkryetari Mujka takohet me menaxhmentin e Stacionit të Autobusëve të Mitrovicës

MITROVICË, 2 QERSHOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të martën ka realizuar një vizitë të Stacionit të Autobusëve në Mitrovicë, me ç'rast është pritur nga drejtori i kësaj ndërmarrje, Xhavit Hasani, kryesuesi i bordit, Kadri Sejdiu, si dhe drejtues të tjerë të kësaj ndërmarrje. Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi lidhur me vazhden e takimeve të cilat do të mbahen me ndërmarrjet publike dhe me procedurat e rifillimit të punës në këto



ndërmarrje pas lirimit të masave të vendosura nga qeveria si pasojë e përhapjes së

virusit Covid-19 si dhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen ato dhe mundësinë që

bashkërisht t'i tejkalojnë ato me mbështetje nga komuna me të gjitha mundësitë që kanë në dispozicion.

Me këtë rast, drejtori i Stacionit të Autobusëve, Xhavit Hasani, ka falënderuar nënkryetarin Mujka për vizitën dhe interesimin e komunës për këtë ndërmarrje, duke e njoftuar atë lidhur me punën dhe vështirësitë nëpër të cilat kalojnë ata, me theks të veçantë gjatë kohës së pandemisë.

Hasani ka bërë me dije se me rifillimin e punës kanë mbajtur

një takim me bordin e Stacionit si dhe bashkërisht me Komunën e Mitrovicës është marrë vendim që prej 1 deri më 7 qershor të lirohen nga pagesat të gjithë operatorët të cilët operojnë në Stacionin e Mitrovicës. Ndërsa nënkryetari Mujka ka falënderuar menaxhmentin e kësaj ndërmarrje për punën dhe kontributin që ka dhënë dhe vazhdon të japë në shërbim të qytetarëve, përkundër asaj që ende nuk e ka një stabilitet financiar dhe një infrastrukturë të përgjithshme të objektit.

Skenderaj do të bëhet me tri çerdhe

SKENDERAJ, 2 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për ndërtimin e çerdhes për fëmijë në mes të lagjeve 2 dhe 3 në Skenderaj. Jashari ka thënë se kjo komunë do të bëhet me tri çerdhe e që, sipas tij, fëmijët do ta kenë edukimin e duhur. "Lajm i mirë për fëmijët e qytetit tonë. Sapo nënshkrova marrëveshjen e



mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë në mes të lagjeve 2 dhe 3 të qytetit tonë. Ndërtimi i kësaj çerdhe do të financohet nga Komuna dhe nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, kurse procedurat për ndërtimin e saj do të fillojnë nga java e ardhshme. Falënderoj zëvendësministrin e MZHR-së, Bashkim Nurboja dhe sekretarin e kësaj ministrie, Fatos Qerimi, për bashkëpunimin dhe

përkrahjen e dhënë. Me ndërtimin e kësaj çerdhe dhe të asaj në lagjen 1 me financimin e Komisionit Evropian, duke përfshirë edhe çerdhen ekzistuese 'Nëna Zahide', qyteti ynë do t'i ketë tri çerdhe dhe kështu fëmijët e qytetit tonë do ta kenë vendin e duhur për edukimin dhe socializimin e tyre të mirëfilltë. Vazhdojmë për ardhmërinë tonë!", ka shkruar Jashari në profilin e vet në "Facebook".

Jashari inspekton punimet në disa rrugë të fshatrave të Skenderajt

SKENDERAJ, 2 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe gjeneral Ilaz Dërguti, Ahmet Zabeli, asamblistin Sami Aruqaj dhe

bashkëpunëtorë të tjerë kanë inspektuar punimet në ndërtimin e rrugës Rezallë-Rezallë e Re, me rreth 3 km gjatësi. Asfaltimi i kësaj rruge shkurton kohën e mbërritjes nga Skenderaj dhe fshatrat përreth

për në Rezallë. Po ashtu, kryetari Jashari e nënkryetari Lushtaku, bashkë me kryetarin e fshatit Aqarevë, Gentrit Rrahmani, kanë vizituar edhe fshatin Aqarevë, për t'i parë punimet që po

bëhen në asfaltimin e rrugës Aqarevë - Siqevë. "Angazhimi ynë në krijimin e infrastrukturës moderne në të gjitha fshatrat dhe vendbanimet e komunës sonë nuk do të ndalet", ka thënë Jashari.



Haradinaj: Gjakova, shembull i qeverisjes së suksesshme nga AAK-ja

GJAKOVË, 2 QERSHOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka vizituar të matën Komunën e Gjakovës, ku është shënuar 20-vjetori i themelimit të degës së kësaj partie në këtë komunë. Gjatë qëndrimit në Gjakovë, Haradinaj ka vizituar edhe komunën e drejtuar nga Ardian Gjini. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se gjatë kësaj vizite ishte dëshmitar i qeverisjes së suksesshme të AAK-së në Gjakovë. Ai ka thënë se qeverisja

e Gjinit është duke e ngritur cilësinë e jetës së qytetarëve gjakovarë. "Gjakova është shndërruar në lidere për realizimin e projekteve madhore. Sot isha dëshmitar i qeverisjes së suksesshme të Aleancës në këtë qytet, e cila, përmes investimeve në infrastrukturë, po ngritë cilësinë e jetës së qytetarëve", ka shkruar Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka vizituar edhe vendpunishten ku është duke u ndërtuar stadiumi i ri i futbollit, përgjatë lumit "Krena".

Po ashtu, Haradinaj ka vizituar edhe fabrikën "Comodita", ku ka lavdëruar drejtuesit e kësaj fabrike, duke thënë se është shembull i punës së madhe dhe menaxhimit efektiv të teknologjisë së lartë. "Gjatë ditës vizitova edhe fabrikën 'Comodita', e cila është shembull i punës së madhe, menaxhimit efektiv dhe teknologjisë së lartë, si dëshmi se prodhuesit kosovarë me përkushtim arrijnë të bëhen konkurrentë edhe në tregjet evropiane dhe botërore", ka deklaruar Haradinaj.



Shtyhet deri më 19 qershor afati i deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë publikë

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Në pajtim me vendimin e Qeverisë së Kosovës për lehtësimin e masave pas situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka njoftuar se afati i deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë publikë do të vazhdojë deri më 19 qershor. "Agjencia Kundër Korrupsionit kërkon nga zyrtarët e lartë publikë të cilët nuk e kanë bërë ende deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, deklarimin e pasurisë në pajtim me Ligjin Nr. 04-L-050 për



deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe

deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe

Nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-228, mund ta bëjnë në Agjencinë Kundër Korrupsionit deri më datën 19 qershor 2020. Formulari i deklarimit të pasurisë duhet të plotësohet në pajtim me nenet 5, 6, 7, 8 dhe 10, të Ligjit nr. 04/L-050 dhe Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050. Ndërkaq, zyrtarët e lartë publikë që kanë deklaruar pasurinë me marrjen e detyrës nga 1 janari i këtij viti e deri më tani nuk janë të obliguar të paraqesin edhe deklarimin e rregullt vjetor", ka njoftuar AKK-

ja, raporton "Epoka e re". Bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me situatën rreth Covid-19, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), konform udhëzimeve dhe rekomandimeve institucionale, më 17 mars kishte njoftuar të gjithë zyrtarët publikë se dorëzimi i formularëve të deklarimit të pasurisë mund të bëhet përmes adresës elektronike në info@akk-ks.org dhe se afati për deklarimin e pasurisë shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në normalizimin e gjendjes.

Ish-presidentja Jahjaga kërkon të ruhet mjedisi dhe të shtohen hapësirat e gjelbra



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, i është bashkuar iniciativës së Komunës së Prishtinës për mbjelljen e fidanëve dhe drunjve në kuadër të "Javës së Gjelbër", e cila ka filluar të hënën. Me këtë rast, Jahjaga ka kërkuar që të ruhet mjedisi dhe të shtohen hapësirat e gjelbra. "Uroj Komunën e Prishtinës. Iu kam bashkuar kësaj iniciative të javës globale për të mbjell

fidanë, ku këtë vit po bëhen organizime nga Komuna e Prishtinës, për ta përçuar mesazhin për si ne qytetarë që duhet të kontribuojmë në ruajtjen e ambientit dhe rritjen e vetëdijes për gjeneratat e reja". Ndërsa drejtoresha e Parqeve, Fatime Hajdari, ka falënderuar Jahjagën që i është bashkuar kësaj iniciative. Ajo ka sqaruar se janë mbjellë 50 fidanë dekorativë dhe do të vazhdohet

me aktivitete të tjera gjatë javës. "Ne për gjatë gjithë vitit organizojmë aksione të tilla simbolike për ta shënuar Javën e Gjelbër, por edhe për t'iu treguar qytetarëve që të na bashkëngjiten në aksione të tilla. Kësaj radhe kemi pasur fatin të kemi personalitete të njohura siç është ish-presidentja Jahjaga, e cila në çdo aktivitet tonin nuk ka ngurruar të jetë pjesëmarrëse", ka thënë Hajdari.

KRU 'Prishtina' lanson platformën online të faturës së ujit

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka bërë me dije se ka lansuar platformën online të faturës pa pasur nevojë për pranimin fizik të saj. "Ne tashmë kemi lansuar platformën e faturës online të cilën mund ta keni të gjithë, pa pasur nevojë për pranin fizik të faturës. Brenda kartelës suaj online mund ta

gjeni edhe kodin e faturës, përmes të cilit mund të bëni pagesa me 'e-banking', shpejt dhe sigurt. Për lehtësim kuptimi dhe qasjeje, mund të gjeni videon me hapa sqarues dhe konkretë për hapjen e llogarisë suaj të cilën e gjeni në <http://kartela.kru-prishtina.com>", ka njoftuar KRU "Prishtina".

Kjo kompani ka inkurajuar

konsumatorët e saj që të regjistrohen në këtë platformë. "Ju inkurajojmë të kyçeni dhe të regjistroheni si konsumatorë të KRU 'Prishtina'. Aty mund ta shihni kartelën tuaj financiare, shpenzimin e ujit në metër kub, totalin e shpenzimit dhe faturimit, pagesat tuaja paraprake dhe të tanishme, numrin referent për atë cikël të faturimit e cila

ju shërben për pagesë me 'e-banking' etj. Ju të cilët mund të hasni në ndonjë parregullsi në kartelën tuaj, p. sh. nëse keni realizuar ndonjë pagesë online përmes bankave komerciale apo institucioneve mikrofinanciare (si shkak i mungesës së ofrimit të informatave gjatë procesit të pagesës, nga ana juaj) dhe nuk e shihni që është shkarkuar në

kartelë, ju inkurajojmë që t'i prezantoni te ne dëshmitë mbi pagesën e realizuar dhe automatikisht borxhi juaj do të shlyhet nga sistemi. Me të gjitha kapacitetet e punës po mundohemi që çdo ditë të jemi sa më afër kërkesave dhe ankesave tuaja karshi shërbimeve për ujësjellës e kanalizim", ka njoftuar KRU "Prishtina".

Ahmeti prezantoi investimet e reja në 'Termokos'

Prishtinë, 2 qershor - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar se kanë lansuar projektin "Green Queen" i cili parasheh mbështjelljen e

oxhakut të "Termokosit" me një gjethe çeliku, duke e transformuar objektin industrial në tërësi. "Para qytetarëve të Prishtinës, bashkë me studio '1010' lansuam projektin 'Green

Queen', i cili parasheh mbështjelljen e oxhakut të 'Termokosit' me një gjethe çeliku, duke e transformuar objektin industrial në tërësi. Oxhaku është trashëgimi

kulturore industriale. Mbështjellja me gjelbërim është edhe simbolikë e kalimit nga ndotja në gjelbërim", ka shkruar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook".



OAK-u kërkon nga Ministria e Financave të ofrohet përkrahje për organizuesit e ahengjeve

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 QERSHOR - "Problemet e sektorit të organizimit të ngjarjeve (ahengjeve) gjatë situatës së pandemisë" ishte tema kryesore e diskutimit në takimin e realizuar nga përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me disa prej bizneseve të këtij sektori.

Kryetari i bordit të OAK-ut, Skënder Krasniqi, ka shpalosur rekomandimet që kjo odë ka dërguar tek institucionet me qëllim të përkrahjes së bizneseve. "Edhe pse sektorit të organizimit të ngjarjeve nuk i është ndaluar direkt ushtrimi i veprimtarisë, me vendim të qeverisë për parandalim të përhapjes së pandemisë është ndaluar organizimi i ngjarjeve dhe si rezultat i së cilës janë anuluar 60 festivale. Sektori i



organizuesve të ngjarjeve konsiderohen si një nga zinxhirët më të mëdhenj sezonal, pas gastronomisë, e ndër problemet kryesore me të cilat po përballen si pasojë e mosgjenerimit të të hyrave janë pamundësia e mbulimit të pagave të stafit, pagesa e qirasë

dhe shpenzimet fikse. Po ashtu, po ndikon edhe pamundësia e inkasimit të borxheve të vitit të kaluar, e sidomos mosekzekutimi i pagesave nga ana e institucioneve për bizneset. Gjatë këtij takimi u pajtua që për tejkalimin e gjendjes së rënduar të këtij


sektori dhe që t'u mundësohet mbijetesës në treg është e domosdoshme që të përkrahen nga institucionet përmes subvencionimit të pagave të punonjësve, subvencionimit të qirasë, uljes së TVSh-së për operim, shtyrjes së kredit lines që këto biznese kanë dhe

shtyrjes së tatimeve dhe obligimeve ndaj ATK-së", ka njoftuar OAK-u.

Sipas kësaj ode, këto masa duhet të jenë së paku njëvjeçare në mënyrë që ky sektor të ketë mundësi të rifillimit të operimit dhe të tejkalohet situata e rënduar në të cilën gjenden. "Për dallim nga sektorët e tjerë që kanë pasur shtyrje për disa muaj, këtij sektori i janë anuluar dhe shtyrë për një vit eventet dhe aktivitetet e parapara", është thënë në këtë njoftim.

Në lidhje me këtë çështje, Oda e Afarizmit të Kosovës (OEK) ka përcjellë një shkresë për Ministrinë e Financave dhe Transfereve në mënyrë që kjo kategori e bizneseve të përfshihet në draftin final të pakos dhe rimëkëmbjes ekonomike, të sigurohet përkrahja adekuatë dhe t'i jepet mundësia që ky sektor të mbijetojë.

Aeroporti i Prishtinës: Deri më 8 qershor janë paraparë të realizohen disa fluturime



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ka njoftuar se kur do të nisn fluturimet për këtë muaj. Sipas njoftimit të këtij aeroporti, deri më 8 qershor janë paraparë disa fluturime. "Ne për çdo ndryshim të bërë nga kompanitë ajrore do ta bëjmë përditësimin e informacionit dhe do t'ju mbajmë të informuar. Vëmendje: për fluturime në kthim ju lusim që

pyetjet tuaja t'i adresoni në Ambasadën e Kosovës në shtetin ku ndodhni, ndërsa për bileta kontaktoni drejtpërdrejt kompanitë ajrore dhe agjencitë. Për më tej, ju lusim që të keni mirëkuptim dhe për dokumente udhëtimi kontaktoni autoritetet relevante dhe përcillni informacionin e ambasadave/zyrave të huaja në Kosovë në faqet e tyre zyrtare", ka njoftuar ANP "Adem Jashari". Sipas këtij njoftimi, më 3 qershor

do të realizohet fluturimi nga Prishtina për në Zurich, duke filluar nga ora 9:20, ndërsa më 6 qershor do të realizohen këto fluturime: Prishtinë-Stuttgart (ora 09:10), Prishtinë-Munich (ora 09:45), Prishtinë-Hamburg (ora 19:25) dhe Prishtinë-Dusseldorf (ora 19:30). Kurse më 7 qershor do të realizohen këto fluturime: Prishtinë-Dusseldorf (ora 09:45), Prishtinë-Stuttgart (ora 09:50) dhe Prishtinë-Munich (ora 14:10).

Mustafa njoftohet me sfidat e sektorit të qumështit

Prishtinë, 2 qershor (ER) - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Besian Mustafa, të martën priti në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit dhe Rrjetit të Shitësve me Pakicë, ku është diskutuar për

sektorin e qumështit pas situatës së krijuar si pasojë e Covid-19. "Gjatë takimit ministri Mustafa ka diskutuar për sfidat e sektorit të qumështit si dhe për mundësitë e përbashkëta për ta përkrahur sektorin që të dalë nga kjo gjendje pas

pandemisë COVID-19. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit dhe Rrjetit të Shitësve me Pakicë e falënderuan ministrin Mustafa për gatishmërinë e tij për bashkëpunim dhe përkrahje", ka njoftuar MBPZHR-ja.



Më 9 qershor mbahet ankandi i shtatë i letrave me vlerë

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Ministria e Financave dhe Transfereve ka njoftuar se më 9 qershor do të mbahet ankandi i shtatë për vitin 2020. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me

maturitet trevjeçar në shumën prej 30 milionë eurosh. Në një komunikatë drejtuar mediave, Ministria e Financave dhe Transfereve ka bërë me dije se "investimi në Obligacione është inves-

tim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi". "Për detaje rreth

pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit të kontaktojnë ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", është thënë në komunikatën dër-



guar medieve nga Ministria e Financave dhe Transfereve.

Banka Botërore: 88 për qind e sektorit privat në Kosovë është goditur gjatë kohës së pandemisë

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Banka Botërore (BB) ka theksuar se goditjen më të madhe gjatë pandemisë në Kosovë e kanë marrë punëmarrësit e sektorit privat me 88 për qind, të cilët, pavarësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore, bizneset e të gjitha ekonomive po pësojnë humbje.

Në raportin "Tregjet e punës të Ballkanit Perëndimor nën krizën COVID-19", të publikuar nga Banka Botërore, është theksuar se kufizimet mbi lëvizjen dhe mbajtja e distancës fizike kanë cenuar ofertën dhe kërkesën e krahut të punës, transportin dhe udhëtimet në mënyrë të paprecedentë. Raporti ka rikujtuar se janë mbyllur sektorë të tërë të ekonomive kombëtare: hoteleri-restorantet, tregtia jo e domosdoshme me pakicë, turizmi, transporti dhe një pjesë e mirë e prodhimit dhe, pavarësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore, bizneset e të gjitha ekonomive po pësojnë humbje, çka rrezikon operacionet dhe aftësinë e tyre paguese.

Më të prekura, sipas BB-së, janë firmat e vogla dhe të mesme si

dhe bizneset joformale. BB-ja ka theksuar se në fund të vitit Kosova kishte rritjen më të madhe të numrit të personave të punësuar: 6.7 për qind në normë vjetore. Banka Botërore ka thënë se në dy vjetët e fundit në Kosovë dhe në Malin e Zi pagat janë rritur mbi 2 për qind. Megjithëse Kosova është vendi me rritjen më të madhe të punësimit, ka ende një sasi të madhe fuqie punëtore të pashfrytëzuar ende.

Në vitin 2019 norma e papunësisë ra në 13.4 për qind, 2.3 pikë përqindjeje më pak se në 2018-n, ku në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut ra me 3.5 pikë përqindjeje. Por, kur filloi kriza, thuajse një e dyta e popullatës së rajonit në moshë pune qe jo aktive. Në Kosovë pasiviteti qe rritur madje përpara krizës: 70 për qind të kosovarëve kriza i gjeti pa punë. Megjithëse Kosova është ende shumë mbrapa, sukseset e para e kanë rritur shkallën e pjesëmarrjes së femrave në mbi 22 për qind të grave në moshë pune. Derisa përmend të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, në raport është thënë se shoqëritë tregtare kanë kaluar me shpejtësi drejt masave



mbrojtëse: kanë ndryshuar orarin e punës, kanë bërë shkurtime të përkohshme të orëve të punës, kanë detyruar punonjësit të marrin lejen vjetore, leje pa të drejtë roge dhe ka pasur edhe shkurtime të vendeve të punës për ta përballuar rënien e operacioneve apo, madje, edhe mbylljen e detyruar.

Kurse, sa i përket Kosovës, Banka Botërore ka përmendur

firmat që kanë regjistruar një numër shumë më të lartë punonjësish si rishtazi të papunë, çka tregon se mbështetja për punësim, e cila u është dhënë punonjësve të sektorit formal në kuadër të paketës fiskale të qeverisë për situatën e jashtëzakonshme, ka kontribuar në formalizimin e punëmarrësve. Banka Botërore ka theksuar se një shoqatë biznesi në Kosovë ka

konstatuar se 84 për qind e firmave të anketuara ose qenë mbyllur plotësisht, ose punonin me kapacitet të reduktuar ose me orare të reduktuara pune dhe rreth 29 për qind e kishin ulur numrin e punonjësve. Në Kosovë hendeuku gjinor i cili ekzistonte më parë, sipas BB-së, tregon se vetëm 13 për qind e punonjësve të prekur do të jenë vajza/gra.

Ministria e Ekonomisë: Do të largohet nga tregu vetëm mallrat që janë në kundërshtim me ligjin



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS) ka njoftuar se ka urdhëruar largimin nga tregu vetëm për mallrat të cilat kur janë importuar kanë qenë në kundërshtim me ligjin dhe vendimet që kanë qenë në fuqi në atë kohë. Sipas MEPTINIS-it, inspektorati i tregut nuk ka marrë asnjë veprim të palejuar ose në dëm të bizneseve që respektojnë ligjin. "Ju

njoftojmë se Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS) ka urdhëruar largimin nga tregu VETËM mallrat që kur janë importuar kanë qenë në kundërshtim me ligjin dhe vendimet që kanë qenë në fuqi në atë kohë. Inspektorati i Tregut nuk ka marrë asnjë veprim të palejuar ose në dëm të bizneseve që respektojnë ligjin", është thënë në sqarimin e MEPTINIS-it.

Kriza ekonomike, mundësi për një model të ri ekonomik Kosovë - Shqipëri

Ajo që duhet të bëhet tani është shfrytëzimi i kësaj situatë ekonomike që ekonomitë tona, të Kosovës dhe të Shqipërisë, të dalin nga korniza e të vepruarit dhe të menduarit në të cilën janë tash e dy dekada. Ekonomitë tona të vogla nuk do të duhej të izoloheheshin më tej nga njëra-tjetra si pasojë e krizës ekonomike, por do të duhej të shfrytëzohej kjo situatë që të shndërrohen në një ekonomi të përbashkët. Në rrugë e sipër për t'u shndërruar në një ekonomi të përbashkët edhe masat e luftës kundër krizës do të ishin të tilla që nuk do të kishin një efekt afatshkurtër socio-ekonomik, por ndikimi i tyre do të ishte afatgjatë dhe në funksion të ndryshimit të strukturës sonë ekonomike dhe të orientimit në zhvillim të përsheptuar dhe të qëndrueshëm ekonomik



Shkruan: Valon MURATI

1. Zakonisht krizat nëpër të cilat kalojnë shoqëritë, ndonjëherë edhe pjesë të mëdha të njerëzimit, përveçqë krijojnë rreziqe të mëdha për shoqëritë dhe njerëzimin, ato njëkohësisht mund të ofrojnë edhe mundësi të mëdha. Ato mund të shtrojnë rrugë deri atëherë jo shumë të njohura, por të cilat, duke mos qenë konvencionale, mund të bëjnë kapërcime të mëdha në zhvillimin njerëzor. Të tilla janë edhe krizat ekonomike. Modelet ekonomike që deri në kriza ekonomike nuk kanë mundur as të paramendohen se mund të realizohen, në situata të tilla mund të gjejnë zbatim me më shumë lehtësi. T'i përmendim dy prej tyre, të njohura për shumicën, si dëshmi e kapërcimeve të mëdha: atë që njihet si New Deal ("Marrëveshja e re") në SHBA pas Depresionit të Madh të viteve 1929-1933, si dhe rimëkëmbja e ekonomive evropiane pas Luftës së Dytë Botërore përmes Planit Marshall. Në të dyja rastet, por gjithsesi në rrethana krejtësisht të ndryshme, në shoqëritë me ekonomi të tregut kemi ndërhyrje të shtetit (të SHBA-ve) në funksion të kapërcimit të krizës dhe të shtrimit të rrugës për zhvillim të hovshëm ekonomik. Në rastin e parë është karakteristike ndërhyrja ekonomike e qeverisë amerikane, sidomos përmes investimeve në projekte të mëdha publike, për të tejkaluar një krizë të thellë ekonomike si pasojë e

recesionit të madh dhe në të dytën përmes ndihmave financiare amerikane të gjithanshme në rindërtimin e ekonomive të Evropës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore. Në të dy rastet është arritur kthimi i ekonomisë jo vetëm në normalitet, por lakorja e zhvillimit ka marrë përpjetën dhe njëkohësisht mirëqenia e qytetarëve është rritur.

2. Sot bota e ballafaquar me pasojat e pandemisë COVID-19 për shkak të mbylljes disamujore të ekonomive rrezikohet të futet në një recesion të gjatë. Ekonomitë e botës po reagojnë në mënyra të ndryshme, por të gjitha duke iu përshtatur interesave të tyre do të bëjnë përpjekje për të forcuar ekonomitë e tyre. Rrjedhimisht, mund të pritet një kthim drejt ekonomive kombëtare përmes pakove stimuluese për t'i ringjallur ato. SHBA-të tanimë kanë ndarë mbi 2 trilionë dollarë në përpjekjet për ta ndihmuar ekonominë, kurse BE-ja, megjithëse me vonesë, po punon në krijimin e një fondi prej 750 miliardë eurosh që do t'u jepet në formë të granteve (500 miliardë euro) dhe kredive (250 miliardë euro) sektorëve të caktuar ekonomikë në nevojë në vendet e BE-së që janë prekur më së shumti ekonomikisht nga pandemia. Sigurisht, ky është edhe një reagim solidariteti evropian aq i munguar në fazën e parë të pandemisë. Ky fond është pjesë e një kompromisi franko-gjerman (të cilët propozuan 500 miliardë euro, por Komisioni i BE-së e ngriti në 750 miliardë euro) dhe për shumikënd ishte e habitshme se si Gjermania, në parim konservatore sa i përket ndarjes së përgjegjësisë financiare (rrjedhimisht edhe të borxheve të mundshme që nuk

do të mund të paguheshin) me vendet të cilat kanë një disiplinë të vogël të shpenzimeve financiare, ishte pajtuar për një fond të tillë ndërhyrës në ekonomitë e Evropës. Por, për dallim prej vitit 2008 dhe krizës në Greqi e Portugali, kur Gjermania hezitonte të merrte përsipër pagesën e borxheve të këtyre vendeve, sot një goditje e ekonomive të Italisë dhe Spanjës do të thoshte edhe një goditje e ekonomisë gjermane, e cila ka një shkëmbim të madh tregtar me këto dy vende. Për më tepër, industria automobilistike gjermane varet nga prodhimi i pjesëve të cilat bëhen nga industria italiane. Një goditje e kësaj të fundit do të dëmtonte rëndë edhe vetë industrinë gjermane.

3. Kriza ekonomike sigurisht do ta godasë kësaj radhe edhe Kosovën, për dallim prej goditjes më të vogël që Kosova pësoi në vitin 2008 për shkak të strukturës së saj ekonomike dhe të integritit të saj të vogël në atë kohë në ekonominë globale. Sigurisht që qeveria e Kosovës do të vazhdojë të marrë masa dhe do të përpjetë që goditja të jetë sa më e vogël. Masat e pakos së parë emergjente natyrisht ishin më shumë të natyrës socio-ekonomike, përderisa pakoja e fundit ekonomike, ajo e rimëkëmbjes ekonomike e propozuar këto ditë nga ministri i financave në detyrë Besnik Bislimi, është e menduar të jetë më afatgjatë dhe me ndikim jo vetëm në kapërcimin e krizës, por edhe në mundësitë e hapjes së rrugës për zhvillim ekonomik. Një situatë të njëjtë të ndërhyrjes së qeverisë e kemi edhe në Republikën e Shqipërisë. Këto masa do të kritikohen e lavdërohen, varësisht prej këndvështrimit qoftë politik, qoftë të interesit ekonomik, por edhe të vizionit e të shkollës ekonomike që përfaqësojnë ata që do të debatojnë për to. Një është e vërtetë: trendi i masave të të dy shteteve është krejtësisht në frymën e izolimit dhe të marrjes vetëm me veten, e në këtë rast edhe të injorimit të njëra-tjetrës dhe të mundësisë së solidaritetit apo të bashkëpunimit në tejkalimin e përbashkët të kësaj krize ekonomike. Ndërsa do të duhej të ndodhte pikërisht e kundërta. Ajo që duhet të bëhet tani është shfrytëzimi i kësaj situatë ekonomike që ekonomitë tona, të Kosovës dhe të Shqipërisë, të dalin nga korniza e të vepruarit dhe të menduarit në të cilën janë tash e dy dekada. Ekonomitë tona të vogla, nuk do të duhej të izoloheheshin më tej nga njëra-tjetra si pasojë e krizës ekonomike, por do të duhej shfrytëzuar kjo situatë që të shndërrohen në një

ekonomi të përbashkët. Në rrugë e sipër për t'u shndërruar në një ekonomi të përbashkët edhe masat e luftës kundër krizës do të ishin të tilla që nuk do të kishin një efekt afatshkurtër socio-ekonomik por ndikimi i tyre do të ishte afatgjatë, e në funksion të ndryshimit të strukturës sonë ekonomike dhe të orientimit në zhvillim të përsheptuar por edhe të qëndrueshëm ekonomik.

4. Për t'u shndërruar në një ekonomi të përbashkët duhet vizion e guxim politik për t'i tejkaluar barrierat e deritanishme, por edhe modelet përkatëse të zhvillimit ekonomik dhe duhet pasur projekte konkrete. Miku im Gjergj Buxhuku, administratori i Kofindunstrisë së Shqipërisë, një prej përkrasësve më të mëdhenj të një ekonomie të përbashkët shqiptare ka vite që lobon për një mendësi ndryshe të zhvillimit ekonomik dhe rrjedhimisht për një model tjetër ekonomik. Sa isha ministër i diasporës disa herë kemi organizuar konferenca të përbashkëta me Kofindustrinë dhe ministritë përkatëse në Tiranë e Prishtinë për të prezantuar këto modelet të reja ekonomike, por fatkeqësisht ato nuk kanë avancuar përtej këtyre konferencave. Projekti i cili kishte nisur dhe trajtohej si mundësi e një modeli suksesi të bashkëpunimit ishte ai i interkoneksionit 400 KV (i financuar nga KfV gjermane) e i cili një kohë u bllokua nga Serbia, por i cili më në fund rezultoi me daljen e Kosovës nga blloku energjetik i Serbisë dhe bashkimi me atë të Shqipërisë (një zhvillim ky jashtëzakonisht pozitiv për pavarësinë energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë dhe fuqizimin e potencialeve të tyre energjetike). Sidoqoftë, projektet e tjera të mëdha nuk është se u bënë shumë përshtypje politik-bërësve në Prishtinë e Tiranë, e besa as ndërkombëtarëve. Personalisht e kam pasur bindjen se pengesat në këtë rrugë ishin dy: e para, politikanët tanë provincialë në Prishtinë e Tiranë e kishin (dhe si duket e kanë ende) të vështirë të dalin nga kufijtë mendorë provincialë dhe mendojnë vetëm për oborrin e vet në planin afatshkurtër elektoral (madje edhe kur është në pyetje zhvillimi ekonomik) dhe e dyta, kishte vazhdimisht një rezistencë ndërkombëtare ndaj një modeli të ri ekonomik përveç atyre që ta zëmë FMN-ja, BB-ja apo edhe BE-ja kishin promovuar në Kosovë e në Shqipëri për vite të tëra. E mos të flasim këtu edhe për frikën se projekte të tilla ekonomike do të mund të ishin prelude edhe i zhvillimeve të tjera politike në rajon. Sidoqoftë, tani po futemi në rrethana të reja, kur politik-bërësit që janë në pozita vendimmarrëse

do të duhej të ishin të guximshëm që me projekte të mëdha ekonomike të bënin hopin e madh të zhvillimit ekonomik. Njëkohësisht po krijohen edhe kushtet që me projekte konkrete e të përpunuara mirë edhe si modele financiare fitimprurëse, ky model i ri i zhvillimit ekonomik dhe i bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë të shtyhet përpara edhe në raport me organizmat ndërkombëtarë politikë, e edhe me ata ekonomikë dhe financiarë.

5. Po cila është filozofia kryesore prapa modelit ekonomik të mikut tim Gjergj Buxhukut? Sipas tij, e vetnja mënyrë për të ndryshuar strukturën ekonomike të Kosovës dhe Shqipërisë është duke dizajnuar disa projekte të mëdha zhvillimore ekonomike të përbashkëta, në vlerë deri në 10 miliardë euro, të cilat do ta lëviznin me hapa të mëdhenj krejt ekonominë e përbashkët shqiptare, duke e ngritur jo vetëm mirëqenien ekonomike, por duke e emancipuar edhe mentalitetin shoqëror e politik. Këto projekte të përbashkëta mund të jenë: investimet në Trepçë dhe krijimi i metalurgjikëve përreth kombinatit, investimet në industrinë e kromit në Shqipëri, investimet në një termocentral të ri deri në 500 MW (qoftë në rrafshin e Kosovës, qoftë në atë të Dukagjinit), investimet në burimet e ripërtëritshme të energjisë (sidomos duke shfrytëzuar potencialin e madh ujqor të Republikës së Shqipërisë), bursa e përbashkët energjetike, investimet në një projekt të madh turistik në Brezovicë, investimet në fushën e teknologjisë informative për ta shndërruar Kosovën e Shqipërinë në një Silicon Valley të Ballkanit, hekurudha Prishtinë-Durrës, bujqësi dhe turizëm të integruar përmes investimeve të përbashkëta e projekteve komplementare në këto dy fusha, lidhja e Kosovës me projektin e gazit i cili kalon përmes Shqipërisë etj. Ideja bazë është që këto projekte të mëdha ekonomike të jenë nisma të Kosovës dhe Shqipërisë, pra të jenë fillimisht investime të shteteve tona, të cilat duke qenë të tilla krijojnë siguri për t'ua hapur derën fillimisht investimeve nga diaspora në formën e aksioneve në këto projekte, e më pas edhe përmes tërheqjes së investitorëve seriozë strategjikë në varësi nga sektori. Këto propozim-projekte dhe të tjera sigurisht që do të duhej të futeshin në sitën e një ekspertize të përbashkët qeveritare dhe profesionale qoftë nga academia, qoftë nga shoqëria civile dhe biznesi dhe do të duhej të përcilleshin edhe me ndryshimet e duhura ligjore. Sigurisht, do të

duhej krijuar një autoritet i përbashkët publik investues i cili do të mbaronte barrën e projekteve dhe investimeve fillestare në këto projekte të përbashkëta.

6. Me një model të tillë të ri ekonomik jo vetëm që do të shtrohej rruga për tejkalim më të lehtë të krizës, por do të krijoheshin kushtet për një zhvillim të tillë ekonomik që do ta ndryshonte peizazhin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë, duke i zënë dekadat e humbura. Kështu me investimet e shtetit në projekte të mëdha në fazën fillestare dhe me futjen e parasë në qarkullim jo vetëm që do të rritej kërkesa agregate aq e dëshiruar për kapërcimin e krizës ekonomike, por do të gjallërohej e rinohej krejt zinxhiri i ekonomisë kombëtare. Do të hapeshin krejtësisht horizontet e reja të zhvillimit ekonomik që do të kishin ndikime të qëndrueshme jo vetëm në planin ekonomik, por edhe në fushat e tjera, e sidomos në arsim, në çështje sociale, në sundim të ligjit e në stabilitet politik. Së dyti, do të mund të mobilizoheshin burime financiare dhe njerëzore e intelektuale të diasporës, duke i vënë ato në shërbim të vendit, e me përfitim të dyanshëm. Zakonisht financat e diasporës ne nuk kemi ditur dhe nuk kemi mundur t'i orientojmë në mënyrën e duhur edhe për shkak të mungesës së projekteve të detajuara ekonomike në të cilat do ta ftonim diasporën të investonte. Projektet e tilla, në të cilat diaspora do të kishte përparësinë e blerjes së aksioneve, do të ndikonin në afrimin më të madh të tyre me atdheun, si dhe do t'u mundësonte investim në atdhe jo vetëm biznesmenëve, por edhe atyre që kanë kursime e duan që diçka nga ato t'i investojnë në vendin e tyre. Krejt ky zhvillim do ta bënte ekonominë tonë më të sigurt, më të qëndrueshme dhe më të besueshme edhe për investitorët e huaj. Ardha e tyre në tregun tonë do të hapte të tjera perspektiva dhe do të ndihmonte edhe në ndryshimin e mentalitetit tonë ekonomik. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, një model i tillë ekonomik do t'i thyente barrierat provinciale në mes Prishtinës e Tiranës, duke ndikuar që krijimi i një ekonomie të përbashkët të krijonte edhe interesin e përbashkët për projektin politik të bashkimit.

7. E nëse nuk do të guxojmë të lëvizim nga vendi edhe në këto kohë krize, do të jemi të dënuar të sillemi në këto çifligjet tona të vogla me debate se sa qindra milionë u futën në ekonominë tona të vogla, se në cilët sektorë u futën apo ku do të duhej të futeshin, se kush po përfiton më shumë, e kush më pak nga ndërhyrjet në ekonomi, por gjithëherë duke mbetur të vegjël në zhvillim e në mendësi, e gjithnjë duke mbetur shumë prapa botës. Kjo botë është për ata që guxojnë. Andaj ta shfrytëzojmë këtë moment për lëvizjen e madhe ekonomike!

Mbi zgjedhoren, turp për politikën shqiptare: dy vjet pa kokëçarje, dy ditë me alarm



Prof. Lisen BASHKURTI

Turp i madh për politikën shqiptare! Prej më shumë se dy vjetësh kanë pasur kohë të bëjnë reformën zgjedhore, por as që e kanë vënë ujin në zjarr për këtë. E tani, në dy ditët e fundit të afatit të vënë nga ndërkombëtarët dhe në marrëveshje me faktorin vendor, dridhen e përdridhen për ta gjetur kompromisin lidhur me draftin përfundimtar të kësaj reforme, që më pas duhet të votohet në Kuvendin e Shqipërisë. Ka më shumë se dy vjet që OSBE/ODIHR, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Këshilli i Evropës dhe shtete të veçanta të demokracive të konsoliduara i kërkojnë politikës shqiptare që të bëjnë reformë zgjedhore për t'i parandaluar parregullsitë e zgjedhjeve të konstatuara në ato të përgjithshmet në vitin 2017 dhe në vendoret në vitin 2019.

1. Mungesë përgjegjësie

Në çdo reformë, por edhe në çdo strategji, event, prioritet, projekt, program krahas planit të veprimit dhe masave që lypet të ndërmerren është e domosdoshme të parashikohet edhe kalendari kohor i plotësimit të detyrimeve. Strategjitë, eventet, prioritetet, projektet apo programet politike pa afate kohore të zbatimit të tyre ose në shkelje të këtyre afateve janë mungesë e plotë përgjegjësie për faktorët politikëbërës dhe vendimmarrës. Mungesa ose tallja me afatet kohore zbatuese të politikave, respektivisht edhe të reformave të çdo fushe shprehin një politikë që nuk respekton as veten, as qytetarët dhe as ndërkombëtarët. Politika është proces. Si e tillë ajo zhvillohet në kohë. Koha në politikë është themelore. Shpërfillja e kohës, mosrespektimi i afateve kohore, tallja me to janë reflektime të një politike të vjetër, të dalë boje, pa respekt për veten e saj, pa detyrime

ndaj qytetarëve dhe pa konsideratë ndaj faktorëve ndërkombëtar që asistojnë dhe mbështesin.

Data 31 maj 2020 ishte fiksuar në mendjen e çdo qytetari shqiptar, të çdo medie, të çdo partneri ndërkombëtar si data e finalizimit të konsensusit të reformës zgjedhore. Është një reformë themelore për demokracinë shqiptare. Është një reformë e munguar prek kohësh. Është alarm për qytetarët e këtij vendi. Është kërkesë, gati-gati ultimative nga BE për fillimin e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë.

Papërgjegjshmëria e politikës shqiptare po trondit qytetarët shqiptarë, po habitë mediat e huaja më prestigjioze, po çuditë partnerët tanë ndërkombëtarë. Politika shqiptare jeton jashtë kohe...deklarohet jashtë kohe...punon jashtë kohe...vepron jashtë kohe...koha për politikën shqiptare është e pakonsiderueshme, e pavlefshme, e pa rëndësishme. Kudo në botë, por edhe populli ynë thonë "Koha është flori", "Koha është para", "koha është gjithçka". Vetëm për politikën shqiptare "koha është asgjë". Në kokën e politikës shqiptare është rrënjosur thellë-thellë, shumë thellë, aq thellë sa nuk shkulet dot, trashëgimia e tmerrshme orientaliste mesjetare... "avash-avash"... "punët e mira bëhen ngadalë"... "mos të nxitohemi"...etj. Janë këto recidiva primitive që e kanë lënë Shqipërinë nga një vend gjeografikisht në oborrin e mesëm të Evropës, në një periferi të prapambetur të saj. Turp!

2. Mungesë besimi

Sa herë që lind nevoja për të hedhur hapa kompromisi apo vendime konsuale faktori politik kryesorë në vend, mazhoranca dhe opozita bllokohen tërësisht. Vendi tronditet i tëri. Qytetarët pezmatohen aq shumë sa u mërzhiten edhe vendi ku kanë lindur dhe jetojnë e punojnë. Ekonomia fillon të rrëshqasë teposhte. Problemet sociale përkeqësohen. Imazhi i vendit rrënohet. Partnerët ndërkombëtar zhgënjehen dhe reagojnë në mënyra nga më të çuditshmet.

Në këto momente kompromisi të munguar dhe konsensusi të

paarritshëm midis mazhorancës dhe opozitës politike në Shqipëri ngrihet një mur mosbesimi që na kujton "Murin e Madh Kinez" midis Kinës dhe Mongolëve, apo "Murin e Berlinit" midis dy blloqeve të Luftës së Ftohtë. A thua se mazhoranca dhe opozita shqiptare janë dy realitete "extra terra", jashtë mjedisit shqiptar, pa lidhje me këtë vend, pa ngjashmëri me këtë komb, pa agjendë të përbashkët me këtë popull, pa kontinuitet bashkëpunimi me partnerët tanë ndërkombëtar. Përballë çdo kompromisi e konsensusi në politikën shqiptare ngrihen instikti i të keqes, inati, skepticizmi, urrejtja, frika, armiqësia. Lartësohen si përbindës mburrjet për vetveten dhe fajësimet për kundërshtarët. Faji i vërtetë mbetet jetim. Ose më së shumti i vishet popullit, dhe, kohët e fundit, edhe partnerëve ndërkombëtar.

Rreth tryezave të rrumbullakëta të dizajnuara për kompromise dhe konsensus dalin thepat e mprehtë të konfliktit të interesave dhe hidhen tej interesat qytetare e kombëtare, lartësohen egoizmi e megalomania, pragmatizmi vulgar dhe materializimi konsumist. Një liderizëm i sëmurë ngrihet mbi këtë vend të rrënuar e popull të varfër. Partnerët pezmatohen dhe revoltohen. E si pasojë, gjithë bota lëviz, ndryshon, zhvillohet, ndërsa Shqipëria rrinë në status quo.

Turp, vërtet, turp!

3. Mungesë aftësie

Tek i sheh politikanët shqiptarë rreth tryezave të negociatave të merren mendtë nga mendimet, qëndrimet e veprimet e tyre. Mendime kaotike, fjalë pa lidhje, emocione jashtë kontrolli, gjuhë trupore halucinacionesh. Sikur tryeza e negociatave të jetë fushë e minuar, gati për të shpërthyer. Tek politikanët negociatorë shqiptarë, instinktet frojdiste prevalojnë mbi qetësinë, njerëzoren, racionalen, të arsyeshme, të drejtën dhe të dobishmen.

Lexohet qartësisht se palët hyjnë në negociatë pa strategji të vizionare, pa objektiva madhore, pa prioritetet, pa një plan veprimi, pa një afatizim kohor, pa masa që duhen

ndërmarrë, pa ndarje rolesh, pa skenarë alternative, pa kurrfarë parashikueshmërie, pa llogaritjen e riskut, pa bërë hesapin kosto-përfitim, pa konsideruar pasojat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate, pa taktika ç'bllokuese dhe dalje në rast krizash negociuese. Pra, pra asnjë palët politike negociuese në Shqipëri janë pa asnjë bazë edukimi, informimi, formimi, profesionalizmi dhe aftësie negociuese.

Pra, qartësisht politikanët negociatorë shqiptarë shkojnë në tryeza bisedimesh me një mal paragjykimesh për njëri-tjetrin dhe për kundërshtarin, ulen në tryeza me projekte ad-hoc, mbi baza spontane, me filozofinë "të dale, ku të dalë", me hilenë "për t'ia hedhur njëri-tjetrit", për tu tallur me qytetarët, për t'i mashtruar ndërkombëtarët.

Paaftësia për të biseduar, dialoguar dhe negociuar politikanëve shqiptarë u lexohet në ballë. Madje u lexohet nga Maja e Everestit. Dhe ku ekziston paaftësia mbillet djallëzia. Politikanë të tillë të paaftë për të arritur kompromise e konsensus brenda vendit të tyre e mbi një popull e një komb të vetëm, nuk mundën kursesi të arrijnë të negociojnë marrëveshje, protokolle e traktate ndërkombëtare me armiq të popullit e Kombit tonë.

Turp i madh për politikën shqiptare! E nisën reformën zgjedhore dy vite më parë, por e lanë në mes pa e nisur mirë. E tani, në dy ditët e fundit, ngrenë sirenat e alarmit për afatin e vënë nga ndërkombëtarët në marrëveshje me faktorin politik shqiptar, pa qenë të përgjegjshëm, të ndershëm dhe të aftë për ta gjetur kompromisin lidhur me draftin përfundimtar të kësaj reforme, që pritet të votohet në Kuvendin e Shqipërisë.

Prej dy vitesh OSBE/ODIHR, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Këshilli i Evropës dhe shtete të veçanta të demokracive të konsoliduara kërkojnë nga politika shqiptare të bëjnë reformë zgjedhore, për të parandaluar parregullsitë e zgjedhjeve kaluara politike dhe vendore si dhe për të filluar negociatat për anëtarësim në BE. Dy vjet pa kokëçarje, dy ditë me alarm! Turp, pafundësisht turp!

Biden kundër mobilizimit nga Presidenti Trump të ushtrisë ndaj protestuesve

Ish-Nënpresidenti amerikan Joe Biden ka shprehur shqetësimin "për vetë shpirtin e vendit tonë" pasi Presidenti Donald Trump u zotua të hënën të përdorë ushtrinë për t'i dhënë fund "trazirave dhe paligjshmërisë" që kanë shpërthyer në të gjithë Shtetet e Bashkuara pas vdekjes së një afrikano-amerikani që mbahej nga policia një javë më parë në Minneapolis.

Në një fjalim televiziv kombëtar në Kopshtin e Trëndafilave të Shtëpisë së Bardhë, presidenti paralajmëroi se "nëse një qytet ose shtet nuk pranon të ndërmarë veprimet e nevojshme për të mbrojtur jetën dhe pronën e banorëve të tyre, atëherë unë do të dislokoj ushtrinë e Shteteve të Bashkuara dhe do ta zgjidh problemin me shpejtësi".

Komenti i referohej me sa duket Ligjit për Rebelimin të vitit 1807, i cili lejon presidentët të veprojnë ndaj paligjshmërisë gjatë emergjencave. Ligji u përdor së fundmi në 1992 në mes të trazirave në Los Angeles pasi një tjetër afrikano-amerikan, Rodney King, u rrah nga policia.

Presidenti Trump tha se ai "po mobilizonte të gjitha burimet e mundshme federale, civile dhe ushtarake, për të ndaluar trazirat dhe plaçkitjet, për t'i dhënë fund shkatërrimit dhe zjarrvënies dhe për të mbrojtur të drejtat e

amerikanëve që respektojnë ligjin, përfshirë këtu edhe të drejtën tuaj të bazuar tek Amendamenti i Dytë". Amendamenti i Dytë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara mbron të drejtat e të gjithë qytetarëve amerikanë për të mbajtur armë zjarri.

Pak para se presidenti të fliste, gazetarët që prisnin për komentet e tij në Kopshtin e Trëndafilave dëgjonin shpërthime të larta nga gazi lotësjellës që hidhej përreth Parkut Lafayette, ku forcat e policisë të veshura me paisje mbrojtëse shtynin me mburoja demonstruesit paqësorë. Gjithashtu u qëllua me plumba gome dhe u fut policia me kuaj për të pastruar zonën.

Lëvizja nga organet e zbatimit të ligjit erdhi më pak se gjysmë ore para orës 7 pasdite, kur shtetërimi hyri në fuqi për Uashingtonin.

Aksioni pastroi rrugën - por jo erën e gazit lotsjellës - rreth Kishës së Shën Gjonit, një bllok më në veri të Shtëpisë së Bardhë, ku Presidenti Trump eci vetëm disa minuta pasi hyri në fuqi shtetërimi. Kisha historike Episkopale, e njohur në Uashington si "kisha e presidentëve", pësoi dëme të vogla mbrëmjen e së dielës kur një zjarr i vogël u ndez në bodrumin e saj.

Përpara kishës së mbyllur, Presidenti Trump mbajti një Bibël,



Garda Kombëtare duke patrulluar në rrugët e Los Anxhelosit

duke iu referuar Shteteve të Bashkuara si "vendi më i madh në botë" dhe tha: "ne do ta ruajmë të sigurt".

Në vazhdim, Presidenti Trump u kthye përsëri në Shtëpinë e Bardhë i rrethuar nga masa të mëdha sigurie.

Disa orë pas fjalimit të presidentit dhe paraqitjes së tij para kishës së Shën Gjonit, Joe Biden, kundërshtari i prezumuar demokrat i presidentit në zgjedhjet presidenciale të nëntorit të këtij

viti, denoncoi veprimet e Presidentit Trump në llogarinë e tij në Twitter. "Ai po përdor ushtrinë amerikane kundër popullit amerikan", shkruajti Biden. "Ai përdori gaz lotsjellës ndaj protestuesve paqësorë dhe gjuajti me plumba gome. Për një foto".

"Për fëmijët tanë, për vetë shpirtin e vendit tonë, ne duhet ta mposhtim atë."

Peshkopja Mariann Budde, udhëheqëse e Dioqezës Episkopale të Uashingtonit, gjithashtu shprehu në Twitter pakënaqësinë e saj me veprimet e Presidentit Trump. "Sonte Presidenti sapo përdori një Bibël dhe një kishë të dioqezës time si sfond për një mesazh që ishte e kundërta e mësimëve të Jezusit dhe gjithçkaje që përfaqëson kisha jonë. Për ta bërë këtë, ai sanksionoi përdorimin e gazit lotsjellës nga oficerët e policisë të veshur me paisje mbrojtëse për të pastruar oborrin e kishës", shkruajti Peshkopja Budde.

"Vendimi i Presidentit Trump për të mobilizuar Ligjin për Rebelimin dhe retorika e tij provokuese, dëshmojnë se ai nuk mund të na udhëheqë në këto kohë të trazuar dhe të bashkojë vendin. Në vend të kësaj, ai ka vendosur të mbështetet në përdorimin e forcës ndaj atyre që ai i konsideron si kërcënim", tha në një deklaratë Ligjvënësi Adam

Smith, kryetar i Komisionit të Forcave të Armatosura të Dhomës së Përfaqësuesve.

Presidenti, sipas zyrtarëve të Departamentit të Mbrojtjes, ka urdhëruar ushtrinë që të dislokojë një batalion të policisë ushtarake në Uashington, juridiksioni i vetëm ku ushtria mund ta bëjë këtë pa u këshilluar më parë me guvernatorin e shtetit.

Njësitë e Gardës Kombëtare

Të gjitha forcat prej 1200 anëtarësh të Gardës Kombëtare në kryeqytetin amerikan janë mobilizuar. Sipas zyrtarëve, pesë shtete po dërgonin me shpejtësi nga 600 deri në 800 ushtarake të tjerë, disa të armatosur me armë vdekjeprurëse.

Forca të tjera ushtarake në shërbim aktiv, ndër to polici ushtarake dhe njësi xheniere, janë vendosur në gatishmëri përreth Distriktit të Kolumbias dhe mund të sillen nëse do të lindë nevoja, njoftuan zyrtarët.

Në orët e vona të së hënës, një helikopter Black Hawk i ushtrisë amerikane fluturoi mbi çatitë e lagjes historike Chinatown të Uashingtonit në një manovër "demonstrimi force", duke i detyruar protestuesit të shpërndahen për të shmangur



Presidenti Trump mban në dorë Biblën ndërsa qëndron përpara kishës së mbyllur

Trumpi, guvernatorëve: Përdorni 'artilërinë e rëndë'

SHBA, 2 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka zhvilluar një takim me guvernatorët e shteteve për sa i përket temës së nxehtë të protestave që kanë shpërthyer në vend. Ai i ka konsideruar krerët e shteteve të dobët dhe se ato duhet të marrin masa më të ashpra për ta menaxhuar

situatën. Sipas asaj që shkruan "CNN", Trumpi duket se është në të njëjtën mendje me guvernatorin e Minnesotas, Tim Walz. Ky i fundit ka përdorur "artilërinë e rëndë" për ta kontrolluar situatën në vend duke nxjerrë forcat ushtarake kundër protestuesve. Mesazhi i Trumpit ishte i qartë: "Nuk po merrni masat e mjaftueshme për

ta menaxhuar situatën. Ju duhet t'i dominoni ata ose do të dukeni si një tufë dështakësh. E gjithë bota po qesh për djegien e Drejtorisë së Policisë në Minneapolis, ndaj unë i sugjeroja guvernatorit që ta përdorë Gardën Kombëtare kundër protestuesve", u është drejtuar Trumpi guvernatorëve sipas CNN-it.



pluhurin dhe sendet që ngrinin helikat e helikopterit, që thyen edhe degët e pemëve.

Veprimet e Presidentit Trump po shihen si demonstrimi më i hapur i forcës autoritare që kur ai mori detyrën 3 vjet e gjysëm më parë.

"Jemi duke u përsiatur drejt një diktature", tha Don Lemon në rrjetin e kabllove të lajmeve, CNN, menjëherë pas fjalës së presidentit.

"Unë mendoj se presidenti po luan një lojë shumë, shumë të rrezikshme këtu".

Presidenti i është referuar vazhdimisht CNN-it si "lajme të rreme" dhe shpesh i karakterizon mediat kryesore amerikane si "armi të popullit".

Presidenti Trump i quan guvernatorët "të dobët"

Më herët të hënën, guvernatorët morën një leksion nga Presidenti Trump, sekretari i mbrojtjes dhe prokurori i përgjithshëm, duke i nxitur ata të bëhen të ashpër me protestuesit e pabindur në rrugët e qyteteve të Amerikës.

Në një konferencë nëpërmjet telefonit me guvernatorët për demonstratat e dhunshme në të gjithë vendin, udhëheqësit e shteteve u kritikuan ashpër nga presidenti.

"Shumica prej jush janë të dobët", u tha presidenti, sipas një regjistrimi audiofonik të telefonatës. "Ju duhet të dominoni. Nëse nuk mbizotëroni, po humbni kohën tuaj. Ata do t'ju shkelin me këmbë; do të dukeni si një tufë budallenjsh".

Presidenti Trump është duke u përballur me kritika për mosmarrjen e rolit tradicional presidencial të "kryengushëlluesit", që kur vdekja e afrikano-amerikanit George Floyd ndërta mbahej nga policia në Minneapolis, shkaktoi një rrjedhë agonie dhe zemërimi kombëtar.



Një automjet ushtarak qëndron në mes të K Street në kryeqytetin amerikan

Në vend të kësaj, presidenti ka kaluar kohën në Twitter duke sulmuar Biden-in dhe politikanë të tjerë demokratë, dhe duke i njehsuar me radikalët e majtë që ai fajëson për dhunën e ditëve të fundit.

Telefonata me Presidentin Trump të hënën ishte "thelësisht shqetësuese", tha guvernatorja demokrate e Michiganit Gretchen Whitmer.

"Në vend që të ofroj mbështetje ose udhëheqje për të ulur temperaturën në protesta, Presidenti Trump u tha qeveritarëve që ta 'shtypni' ose do na 'mposhtin', tha ajo në një deklaratë.

Rreth gjysma e guvernatorëve kanë aktivizuar tashmë njësitë e Gardës Kombëtare për të ndihmuar organet e zbatimit të ligjit në shuarjen e trazirave. Por më shumë ushtarakë janë të nevojshëm në rrugë, sipas presidentit.

"Ata janë të gatshëm, kanë dëshirën dhe aftësitë. Ata duan të luftojnë për vendin", u tha Presidenti Trump guvernatorëve. "Do të doja të kishim një forcë okupuese prezente".

Qyteti Los Angeles, konkretisht, "nuk është duke përdorur burimin më të mrekullueshëm që mund të përdorni", tha Presidenti Trump për forcat ushtarake nën kontrollin e shtetit.

Presidenti Trump dhe Shtëpia e Bardhë po fajësojnë për dhunën një koalicion mes aktivistëve të së majtës së largët, të njohur si "antifa" (shkurtim i fjalës antifashist), anëtarët e të cilës bëjnë fushatë kundër asaj që i shikojnë si akte të autoritarizmit, homofobisë, racizmit ose ksenofobisë.

Presidenti republikan paralajmëroi më herët në Twitter se "kur plaçkitjet fillojnë, të shtënat fillojnë". Presidenti Trump mohoi më vonë që fraza ishte një paralajmërim se vandalët do të qëlloheshin me armë dhe tha se nuk e dinte që shprehja ishte përdorur në mënyrë të dukshme nga shefi i policisë së Majamit në 1967 në përgjigje të kriminalitetit të dhunshëm në lagjet e afrikano-amerikanëve.

"Është një lëvizje që nëse nuk e shtypni, do të përkeqësohet dhe përkeqësohet", u tha guvernatorët Presidenti Trump të hënën. "Këta

janë radikalë dhe janë anarkistë." Sekretarja e Shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Kayleigh McEnany, e pyetur gjatë një konference për shtyp në Shtëpinë e Bardhë në lidhje me reagimin e guvernatorës së Michiganit, tha se ajo nuk e kupton pse Guvernatorja Whitmer do të shqetësohej që presidenti u thotë guvernatorëve të bëjnë punën e tyre.

Një tjetër demokrat, Guvernatori J.B. Pritzker i shtetit Illinois, i tha presidentit, "Unë jam jashtëzakonisht i shqetësuar për retorikën që është përdorur nga ju. Është provokuese".

Presidenti u përgjigj: "Edhe mua nuk më pëlqen shumë retorika juaj," duke kritikuar përgjigjen e Guvernatorit Pritzker ndaj pandemisë së koronavirusit. "Sinqerisht mendoj se mund të kishit bërë një punë shumë më të mirë".

Prokurori i Përgjithshëm William Barr u tha guvernatorëve, "ne duhet të kontrollojmë rrugët ... dhe kjo kërkon një prani të fortë".

Provokatorë profesionistë po kërkojnë të lëvizin nga shtetet e fortë drejt shteteve të dobët për të

shkaktuar rrëmujë, tha zoti Barr, duke shtuar se kjo bazohej në raportet e shërbimeve të zbulimit.

"Të gjithë po kërkojnë pika të dobëta," tha Presidenti Trump. "Duhet të arrestohen këta njerëz" dhe të burgosen për disa vite. "Këta janë terroristë. Ata janë antifa dhe e majta radikale".

Presidenti Trump posaçërisht u bëri thirrje qytetit të Nju Jorkut dhe Filadelfias që "të ashpërsohen".

Presidenti Trump tha se përgjigjia fillestare në Minesota ishte "e dobët dhe patetike", por se Guvernatori i Minnesotas Tim Walz, një demokrat, meritonte lavdërime për dislokimin e Gardës Kombëtare, e cila rrezoj demonstruesit "si kunjat e lojës bowling - një gjë e bukur për tu parë".

Gjatë konferencës me telefon, Sekretari i Mbrojtjes Mark Esper u tha guvernatorëve se "sa më shpejt që të mbushni dhe mbizotëroni hapësirën e betejës, aq më shpejt do të shpërmdahet kjo gjë".

Një javë pasi Floyd, 46 vjeç, vdiq ndërta mbahej nga policia dhe u filmua një oficer i bardhë i policisë që e shtypte në qafë me gjurin e tij për më shumë se 8 minuta, demonstratat paqësore janë lënë në hije nga dhuna urbane në mbarë Amerikën. Bizneset janë vandalizuar dhe plaçkitur, monumentet publike janë dëmtuar dhe oficerët e organeve të zbatimit të ligjit kanë qëlluar me plumba gome dhe gaz lotsjellës ndaj protestuesve, disa prej të cilëve kanë goditur policinë me tulla, fishekzjarre dhe qese me lëngje trupore.

Mijëra njerëz u arrestuan në demonstratat në mbarë Shtetet e Bashkuara të shtunën dhe të dielën.

Të hënën Kalifornia urdhëroi mbylljen e ndërtesave të qeverisë së këtij shteti në qendrat e qyteteve. Në Çikago, dy njerëz u vranë gjatë demonstratave të hënën në zonën periferike Cicero dhe u arrestuan 60 persona, raporto i agjensia e lajmeve Associated Press.

Në Washington, D.C., Kryebashkiakja Muriel Bowser u shtriu orarin e shtetretimit me katër orë, duke filluar nga ora 7 pasdite.

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë McEnany tha për Presidentin Trump se, "ai e kupton dhimbjen" e demonstruesve të ligjshëm. Ajo shtoi se, "është vërtet një turp" që radikalët në rrugë po dëmtojnë mesazhin e protestuesve paqësorë.



Obama dënon dhunën e policisë në protestat në ShBA

SHBA, 2 QERSHOR - Ish-presidenti Barack Obama ka dënuar dhunën e ushtruar në protestat mbarëkombëtare që kanë shpërthyer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) pas vrasjes së një afro-amerikani nga një oficer policie. Nga ana tjetër, Obama ka lavdëruar protestuesit që nuk janë shfaqur të dhunshëm dhe që janë duke kërkuar reforma. Sipas tij, pjesa

më e madhe e protestuesve nuk kanë qenë të dhunshëm. "Pakica i vë njerëzit në rrezik dhe dëmton vetë komunitetin që duhet t'i ndihmojnë protestat", ka thënë Obama. Ai ka thënë se qëllimi i protestës është rritja e ndërgjegjësimit të publikut si dhe të vihen në qendër të vëmendjes padrejtësitë. "Aspiratat duhet të përkthehen në ligje specifike dhe praktika institucionale dhe në një

demokraci, kjo ndodh vetëm kur ne zgjedhim zyrtarë qeveritarë që u përgjigjen kërkesave tona", ka thënë Obama. George Floyd, 46-vjeçar, ka ndërruar jetë më 25 maj, pasi një oficer policie i kishte vënë gjurin në fyt për më shumë se tetë minuta derisa injoronte bërjen me dije të tij "nuk po marr dot frymë!", kishte thënë Floyd. Arrestimi i George Floyd ishte kryer pasi ai



dëshironte të paguante në një supermarket me një

kartëmonedhë 20 dollarëshe të dyshuar si të falsifikuar.

E rrallë

Protestat në Amerikë: Gjunjëzohen oficerët e policisë në shenjë solidariteti



Teksa tensionet vazhdojnë të përshkallëzohen mes protestuesve dhe policëve në disa vende të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, disa përfaqësues të policisë kanë treguar solidaritet duke u gjunjëzuar para protestuesve dhe duke marrë pjesë në marshime. Oficerë të policisë në Nju-Jork, Oregon, Florida, Iowa dhe Kentucky u gjun-

jëzuan para njerëzve që po protestonin në lidhje me dhunën policore dhe racizmin kundrejt komuniteteve afro-amerikane. Policë nga Michigan dhe Virginia iu bashkuan protestave. Protestat e dhunshme vijojnë nëpër të gjithë Amerikën si kryengritje për vrasjen e afro-amerikanit George Floyd.

FOTO E DITES



Skuadra akrobatike e Forcave Ajrore Italiane fluturon mbi Torino, Italinë veriore, si pjesë e festimeve për 74-vjetorin e Republikës Italiane të lindur më 2 qershor 1946.

E jashtëzakonshme

Krijohet avioni elektrik, më i madhi i ngritur ndonjëherë në ajër

Avionët elektrikë, me gjithë disa kufizime aktuale, po bëjnë përparime të mëdha. "Magnix", e specializuar në motorët elektrikë, dhe "AeroTEC", i cili u kujdes për pjesën e inxhinierisë së konvertimit, janë dy kompanitë që e kanë konceptuar, duke elektrizuar një "Caravan Grand Cessna 208B", në aeroplanin më të madh elektrik ekzistues (gjerësia e krahëve është 16 metra). "ECaravan", ky është emri i tij që tashmë ka realizuar një fluturim demonstrimi 30-minutësh rreth Aeroportit Ndërkombëtar të Grand County



në Moses Lake në shtetin amerikan të Uashingtonit. Ai është i pajisur me një motor 750 kuaj fuqi "Magnix Magni" në vend të njësisë së zakonshme të elikës turbo. Për shkak të peshës dhe vëllimit të akumulatoreve, "eCaravan" mund të transportojë vetëm 4 ose 5 persona dhe jo 14 si varianti me një motor termik. Të dy kompanitë kanë thënë se kur teknologjia është e pjekur dhe pasi të merret certifikimi më 2021, "eCaravan" do të jetë në gjendje të transportojë deri në 9 persona deri në rreth 160 km distancë.

BARSOLETA E DITËS



Loni: Bir, e mora pesëshe në gjeografi.
Toni: Mos gënje, bre! Hajt tregomë ku është Franca?
Loni: Franca është në faqen 47 të librit të Gjeografisë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Të lindurit e kësaj shenje duhet t'i shtyjnë projektet e reja. Është e rëndësishme të fokusoheni në çështje më të rëndësishme, të cilat kërkojnë shumë punë. Rekomandohet të bëni udhëtime të shkurtra, ose të vizitoni vende në të cilat nuk keni qenë më parë.</p>	 <p>DEMI Është e rëndësishme të keni parasysh këshillat e personave të afërt, në mënyrë që të shmangni zhbërjen e punës në cilën jeni përfshirë prej disa vitesh. Edhe pse këshillat e tyre mund të duken të vështira për t'u realizuar, ata thjesht po përpiqen t'ju ndihmojnë.</p>	 <p>BINJAKËT Biznesi mund edhe do të presë. Është e rëndësishme t'i kushtoni kohë vetes dhe të bisedoni me persona që ju falin kënaqësi dhe ndajnë me ju eksperiencë nga jeta e tyre.</p>	 <p>GAFORRJA Shpërthimet e pasionit, momentet e xhelozisë ose konfliktet e pabaza janë të gjitha të mundshme. Është thelbësore që të mbani veten nën kontroll dhe të bëni kujdes me fjalët.</p>	 <p>LUANI Nuk rekomandohet të udhëtoni, pasi do të ndiheni mjaft të lodhur. Megjithatë, të relaksoheshi nuk do të thotë të qëndrosh në shtëpi. Mund të shëtitni ose të shkoni në piknik.</p>	 <p>VI RGJËRESHA Rekomandohet të merrni pjesë nëpër aktivitete të qeta. Kushtojini më shumë vëmendje familjarëve, që të shmangni zënkat e mundshme. Mos eksperimentoni me veshjen në mbrëmje.</p>
 <p>PESHORJA Do të ishte më mirë t'i kaloni situata të tilla me buzëqeshje dhe të reagoni sikur nuk i keni marrë për bazë fjalët e tyre. Peshoret që janë në një lidhje do të kalojnë momente mjaft romantike, ndërsa për beqarët e kësaj shenje, fati do të jetë në anën e tyre.</p>	 <p>AKREPI Rrezikoni që të zbuloni rastësisht një informacion mjaft të rëndësishëm. Për ta parandaluar këtë, qetësohuni dhe shmangni thashethemet. Në mbrëmje mund t'ju telefonojë dikush me influencë, i cili mund t'ju japë lajme të mira.</p>	 <p>SHIGJETARI Ruani individualitetin dhe mendimin tuaj personal. Mos u frikësoni nga skandalet e vogla, pasi nuk do të ndikojnë aspak tek ju. Nëse dëshironi të qetësoheni, duhet të dilni jashtë qytetit.</p>	 <p>BRICJAPI Nesër duhet të harroni biznesin në favor të mirëqenies emocionale dhe shpirtërore. Sigurohuni të jeni një shembull moral për fëmijët tuaj. Nëse jeni ende vetëm, mos hiqni dorë nga personi që dashuron.</p>	 <p>UJORI Tejkaloni frikën, ngurtësinë dhe konfuzionin për të pasur sukses në biznes. Në aspektin emocional do të jeni të ngarkuar. Përpiquni ta kuptoni veten dhe të bëni gjëra që ju sjellin gëzim.</p>	 <p>PESHQIT Bëni mirë të kërkonti ndihmën e familjes tuaj. Gjysma e dytë e ditës do të jetë një kohë e mirë për të nisur zakone të reja dhe më të shëndetshme. Mbrëmja do të shpenzohej më bukur nën praninë e partnerit/partneres suaj.</p>

Rihanna thekson linjat trupore për promovimin e të brendshmeve 'Savage x Fenty'

Rihanna ka reklamuar linjën e re të brendshme të "Savage x Fenty", markë kjo që është në pronësinë e vet këngëtares. Dhe ajo vërtetoi sërish se është personi i përkryer për promovimin e të brendshmeve "Fenty". Autorja e hitit "We found love" ka publikuar disa fotografi të reja ku duket tejet atraktive. Rihanna është paraqitur tejet seksi, ndërsa ajo pozoi në veshje intime të gjelbra, me një zbukurim dantelle.




Morena Taraku prezanton tatuazhin e ri



Morena Taraku njihet për tatuazhet që ka në trup. Ajo, përveç të tjerash, ka shtuar një tatuazh të ri. Me anë të një postimi në llogarinë e vet në "Instagram", Morena ka treguar se ka shkruar

thënien: "Besimi vret" (në gjuhën angleze "Trust kills") në pjesën poshtë këmbëve. Kështu, Morena dalëngadalë po mbush trupin me këto vizatime që mbesin përgjithmonë të shkruara në trup.



Anxhela Peristeri shfaqet me bikini pasi humbi disa kilogramë

Këngëtarja e njohur Anxhela Peristeri ka treguar se po i kushton shumë rëndësi fizikut. Anxhela ka publikuar së fundmi një fotografi ku shfaqet me bikini dhe vihet re fiziku i saj i përkryer. Ajo ka marrë komente të shumta që e kompli-

mentojnë për trupin, por edhe për vullnetin që ka pasur për të arritur deri këtu. Kujtojmë se kohë më parë Anxhela ishte më e shëndetshme, por që falë këmbënguljes së saj ia ka dalë t'i ketë format që ka tani.

The Weeknd dhuron 500 mijë dollarë për mbështetjen e protestuesve në ShBA



The Weeknd ka kërkuar nga njerëzit me xhepat e "thellë" donacione për t'i mbështetur protestuesit që po kërkojnë drejtësi për vrasjen e George Floyd, shkruan "Complex". Gjithashtu, The Weeknd ka treguar faturat për një numër kontributesh që ai ka bërë në total 500 mijë dollarë. Artisti "After Hours" ka kontribuar me 200 mijë dollarë në rrjetin global "Lives Matter Black Lives" për

fushatën e "Know Your Right të Colin Kaepernick" dhe 100 mijë dollarë në "National Bail Out". "Vazhdoni t'i mbështesni vëllezërit dhe motrat tanë atje, duke rrezikuar gjithçka për të bërë ndryshime aktuale për jetën e personave me ngjyrë. Duke u bërë thirrje të gjithëve që kanë mundësi të dhurojnë shuma të mëdha dhe nëse keni më pak, ju lutemi jepni aq sa mundeni edhe nëse është një sasi e vogël", ka thënë The Weeknd.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Islami: Ballkani kundërshtar i vështirë, por Feronikeli synon finalen

Përparim Islami për "Epokën e re" ka thënë se Feronikeli kërkon sot rezultat pozitiv në Suharekë, kurse kualifikimin në finale të Kupës synon ta sigurojë në Drenas. "Jemi të gatshëm për ndeshjen ndaj Ballkanit dhe jemi përgatitur për aq sa kemi pasur kohë. Ballkani ka një ekip të mirë, por synimi ynë është të dalim në Evropë dhe shpresojmë në rezultat pozitiv në ndeshjen e parë në mënyrë që në ndeshjen e kthimit të jemi më të qetë", ka thënë Islami

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kampioni në fuqi i Kosovës, Feronikeli, i cili ishte edhe fitues i Kupës së Kosovës në edicionin 2018/2019, është përgatitur maksimalisht për ndeshjen e parë gjysmëfinale ndaj Ballkanit e cila zhvillohet sot nga ora 16:00 në Suharekë.

Mbrojtësi i djathtë i "Niklit", Përparim Islami, të martën në bisedë për "Epokën e re" ka shprehur optimizëm se në këtë ndeshje klubi nga Drenasi do të dalë me rezultat të favorshëm dhe kualifikimin në finale e siguron në ndeshjen kthyesë. "Jemi të gatshëm për ndeshjen ndaj Ballkanit dhe jemi përgatitur aq sa kemi pasur kohë. Ballkani ka një ekip të mirë, por synimi ynë është të dalim në Evropë dhe shpresojmë në rezultat pozitiv në ndeshjen e parë në mënyrë që në ndeshjen e kthimit të jemi më të qetë", ka thënë Islami, i cili ka konfirmuar se klubi nga Drenasi është i kompletuar për këtë ndeshje.

Futbolli u rikthye në Kosovë pas një pauze të gjatë për shkak të parandalimit të përhapjes së koronavirusit dhe ky pushim ka ndikuar negativisht në përgatitjen fizike të futbollistëve. Ballkani u kualifikua në gjysmëfinale të Kupës pasi në çerekfinale e mposhti skuadrën e Dukagjinit të Klinës (2-0), kurse Feronikeli e eliminoi nga Kupa Lirinë e Prizrenit (0-2).

Ndërsa futbollisti i Ballkanit, Arbër Hoxha, ka thënë se kundërshtari ka një skuadër të fortë, por synimi i liderëve të elitës është arritja në finale dhe triumfi në garën e Kupës. "Jemi përgatitur maksimalisht për ndeshjen që na pret me 'Niklin'. Gjithsesi e kemi analizuar kundërshtarin mjaft mirë deri në këto çaste dhe shpresoj shumë në



kualifikimin në finale", ka thënë Hoxha, i cili e ka pranuar se të gjitha skuadrat do të kenë telashe pas pauzës së gjatë për shkak të pandemisë. Për ndeshjen gjysmëfinale të Kupës foli edhe Arbër Potoku, i cili ka parashikuar se Ballkani do të kualifikohet në finale. "Sigurisht që pauzat nuk janë të mira për asnjë futbollist, por kështu është situata dhe duhet të pajtohemi. Besoj se kemi stërvitur dhe jemi përgatitur mjaftueshëm që të fillojmë me në fund me ndeshjet e

Kupës po ashtu edhe në ndeshjet kampionate, kurse synimet tona janë që të tregojmë lojërë të bukura siç kemi treguar deri me tani. Me kualitetin që kemi besoj se do të kualifikohem në finale të Kupës", ka thënë Potoku për "Epokën e re". Siç dihet, klubi që triumfon në garën e Kupës merr pjesë në Ligën e Evropës. Në edicionin e kaluar në këtë garë është paraqitur skuadra e Prishtinës, e cila e kishte mbyllur kampionatin në vendin e dytë dhe Feronikeli kishte triumfuar në të dyja garat.

SHKURT

Kuka mirëpret rifillimin e stërvitjeve

Trajneri i xhudos, Driton Kuka, e ka mirëpritur vendimin për rinisjen e stërvitjeve për klubet sportive në Kosovë përdorur ia uroi rifillim të mbarë të gjithë sportistëve të vendit. "Komiteti Olimpik, pas bashkëbisedimit me Ministrinë e Sportit dhe Shëndetësisë si dhe IKShPK-në, na njoftoi se u dha drita e gjelbër për rifillimin e stërvitjeve për klubet sportive në Kosovë. Sugjerimet dhe protokollet e mënyrës së stërvitjeve ne si federatë do t'ua dërgojmë në e-mail klubeve të xhudos, masa të cilat duhen përfillur me kujdes dhe përgjegjësi", ka shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook".

Berisha, synim i Genoas

Portieri nga Kosova, Etrit Berisha, është i huazuar nga Atalanta në skuadrën e SPAL-it, kurse në verë ai mund të ndërrojë sërish skuadër. Portieri i Kombëtares së Shqipërisë është synim i Genoas dhe transferimi duket shumë i mundshëm për faktin se Berisha nuk është në planet e Atalantës.

Maqedonia tenton t'ia marrë Kosovës talentin Valon Hamdiu

Kosova dhe Maqedonia e Veriut është dashur të përballeshin në gjysmëfinalen e National League më 26 mars, por ky takim u pezullua për t'u luajtur disa muaj më vonë. Kombëtarja maqedonase po tenton të "rrembejë" një prej talentëve shqiptarë që është pjesë e Kosovës U-21. Mbrojtësi i talentuar, Valon Hamdiu, kërkohet me ngulm nga Maqedonia e, sipas "Sport Media", drejtuesit e Federatës kanë nisur nga puna për ta bindur futbollistin e ri që luan te Winterthuri në Zvicër. 21-vjeçari me prindër nga Kumanova luan si qendërmbrojtës, ndërsa ka edhe një pasaportë maqedonase dhe kjo e bën më të lehtë që të luajë për Maqedoninë e Veriut.

KF Arbëria: Nuk do të bëjmë ndryshime në shtabin teknik

Skuadra e Arbërisë, e cila ka siguruar inkuadrimit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, ka njoftuar se nuk është në bisedime me asnjë trajner dhe se drejtuesit aktualë të shtabit teknik e kanë besimin e klubit. "KF Arbëria ka shtabin teknik i cili kryesohet nga kryetrajneri Nuhi Bahtiri, ndihmëstrajneri Arsim Tërshani dhe trajneri i portierëve Xhelil Gashi duhet ta informojnë publikun se KF Arbëria ende nuk ka menduar të shoh më larg rreth çështjes së 'shtabit teknik', pasi nga kjo treshe e trajnerëve e ka krijuar suksesin historik. KF Arbëria do ta respektojë punën e tyre e jo ta nënvlerësojë", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Dobroja e Madhe e Lipjanit.

Mundësit Shala i miratohet bursa olimpike

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Mundësi Egzon Shala ka marrë një lajm të mirë nga Solidariteti Olimpik (SO) i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC). Atij i është miratuar kërkesa e

Komitetit Olimpik të Kosovës për t'iu dhënë bursa olimpike "Tokio 2020", në vend të karateistit Alvin Karaqi, të cilit i ishte ndërprerë bursa, pasi i njëjti vendosi të përfaqësojë një

shtet tjetër. Egzon Shala ka fituar normën olimpike "Tokio 2020" në kategorinë -125 kilogramë të mundjes, e cila i është konfirmuar në muajin shkurt 2020. 29-vjeçari do të përfitojë

350 dollarë në muaj nga SO i KON-it, ndërsa vendimi do të hyjë në fuqi më 1 maj 2020, edhe pse KOK-u kishte kërkuar që kjo t'i mundësohet nga 1 janari 2020. Bursa olimpike nga



SO i KON-it dhe nga KOK-u marrin 18 sportistë elitare.

Qardaku: Edhe një test për Covid-19

MALLAKASTËR, 2 QERSHOR - Një ditë para rifillimit të kampionatit dhe ndeshjes Bylis-Tirana, e programuar për t'u luajtur të mërkurën në orën 17:00, një lojtar i klubit nga Mallakastra ka dalë pozitiv me koronavirus. Bëhet fjalë për Eridon Qardaku, i cili për "Top Channel" është shprehur se ndihet shumë mirë nga ana shëndetësore dhe nuk ka asnjë lloj shqetësimi. "Ndihehem shumë mirë. Kam dal pozitiv, por nga ana shëndetësore jam shumë mirë, në gjendje normale, jam munduar të stërvitem në kushte shtëpie. Momentalisht po mendoja të nisja një seancë stërvitore. Kaq mirë ndihem. Nuk kam asnjë lloj shqetësimi. Simptoma kam pasur vetëm temperaturë shumë të lehtë. Testin e kam bërë më tepër për siguri. Për momentin ndihem shumë mirë. Tani t'ia lëmë kohës", ka thënë Qardaku. "Unë do të doja të kisha bërë edhe një test tjetër sepse nuk jam shumë i sigurt për testin e parë sepse, siç e dimë, ka pasur edhe raste të tjera që testi i dytë ka dalë negativ", ka shtuar ai. I pyetur nëse ka pasur kontakte me shokë të skuadrës, Qardaku është përgjigjur: "Jo. Kam udhëtuar një javë më parë sepse kam pasur një dëmtim në kaviljen e djathtë dhe kam ardhur që të bëj rikuperimin në shtëpi dhe dje, duke udhëtuar drejt Ballshit, sapo



kam mbërritur kam ndjerë si shqetësim një temperaturë shumë të lehtë dhe shumë pak ethe. Kam pasur pak ftohtë natën dhe ia lashë asaj. Për siguri, edhe presidenti u tregua i gatshëm, e kapi situatën në kohë, bëra tamponin, prita përgjigjen dhe dola pozitiv. Nuk pata kontakt me asnjërin sepse

presidenti e kapi në kohë. Kjo është arsyeja që ju thashë se më parë do të kisha dashur të bëja një test tjetër, sepse unë gjatë karantinës kam qenë shumë i rregullt, edhe në shtëpi kam qëndruar dy javë, pa asnjë kontakt të jashtëm. Nuk e di se ku mund ta kem marrë", ka shtuar Qardaku.

Joshua: Përballja me Furyn ka rëndësi për mua

LONDËR, 2 QERSHOR - "Pa asnjë dyshim kjo është e vetmja sfidë që ka tani më shumë vlerë për mua. Kjo është përballja me Tyson Fury". Është kjo deklaratë e dhënë sot nga boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë. Joshua mban titujt kampionë bote në kategoritë WBA, WBO dhe IBF, ndërsa Tyson Fury mban titullin e kategorisë WBC. "Ai ka një titull që unë e dua, që është në listën time të objektivave për të ardhmen", u shpreh Joshua për "The Sun". "Ditën që ai dhe unë do të biem dakord për të nënshkruar për të dueluar së bashku do të jetë e rëndësishme për mua pasi do ta hapë rrugën drejt realizimit të ëndrrës. Do të ma japë mundësinë për ta hedhur atë në tapet", ka deklaruar Joshua.



SHKURT

Sagnol: Sane nuk është lojtar i duhur për Bayernin

Ylli i Manchester Cityt, Leroy Sane që një kohë të gjatë është i lidhur me një kalim në Bayern Munchen. Mirëpo, ish-mbrojtësi i Bayernit, Willy Sagnol është i bindur se futbollisti gjerman nuk është i duhuri për skuadrën "bavareze". "Ai nuk korrespondon aspak me karakterin e Bayernit. Sane është një lojtar jokonstant dhe egoist. Për mua ai nuk është i duhuri për 'bavarezët'. Ai ka pasur shumë probleme te Manchester City dhe Kombëtarja e Gjermanisë", ka thënë Sagnol.

Tetë garat e para në Formula 1 do të mbahen në Evropë

Stinori 2020 i Formula 1 do të nisë në Austri më 5 korrik. Do të jetë gara e parë nga tetë rresht në Evropë. Formula 1 nëpërmjet një komunikate ka njoftuar se dy garat e para do të mbahen në Austri më 5 dhe 12 korrik, ndërsa gara e tretë do të jetë në Hungari. Më pas dy të ketë pauzë dyjavore para se të organizohen dy gara rresht në Britani, dhe do të ketë edhe gara në Spanjë, Belgjikë e Itali. Gjitha garat do të jenë pa praninë e shikuesve dhe me rregulla strikte për të parandaluar përhapjen e koronavirusit. Garat në Britani do të mbahen në Silverstone më 2 dhe 9 gusht. Synimi është që stinori të kompletohet më 13 dhjetor në Abu Dhabi dhe planifikohet zhvillimi i 15-18 garave. Fillimi i stinorit në Formula 1 është shtyrë për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Pesë futbollistë të Barcelonës ishin me Covid-19

Pandemia Covid-19 duket se ka prekur edhe klubin e Barcelonës. Pesë lojtarë nga skuadra e parë dhe dy teknikë u testuan pozitivë me koronavirusin. Sipas informacionit të ofruar nga radioja "Grupo Godó", këto janë raste të kaluara, tashmë të shëruara, të zbuluara që kur La Liga nisi të kryejë testimet e para. Në atë kohë pjesëtarët e ekipit "buagrana" dolën se e kishin marrë virusin, pasi u kryen testet e gjakut. E gjithë skuadra po stërvitet normalisht, me përjashtim të të dëmtuarve, çka tregon se aktualisht të gjithë futbollistët janë të pastër nga çdo infeksion. Asnjë prej tyre nuk do të mungojë në sfidën me Mallorcan, të shtunën, në orën 22:00, për shkak të koronavirusit.

Vdes presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës

Bota e sportit ka marrë një lajm të hidhur të hënë në mbrëmje, pasi presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës (EOC), ka vdekur në moshën 78-vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë. Slloveni Kocijançiq ishte pjesë e EOC-ut prej vitit 2005, duke qenë në fillim anëtar i Bordit Ekzekutiv, kurse prej vitit 2013-2016 ishte nënpresident i EOC-ut. Një vit më vonë (2017), ai u zgjodh president i Komitetit Olimpik të Evropës. Komiteti Olimpik i Kosovës, do ta kujtojë gjatë Kocijançiqin, i cili njihej si mik i madh i sportit tonë, një mbështetës i pakursyer në procesin e anëtarësimit të KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe atë të Evropës.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

